




Përse ta besojmë Biblën

JOHN BLANCHARD

Përse ta besojmë Biblën?

John Blanchard

Titulli i originalit: Why believe the Bible?

Autori: John Blanchard

Botoi: Evangelical Press

Faverdale North Industrial Estate, Darlington, DL3 0PH, England, U.K

ISBN: 0 85234 559 3

Titulli në Shqip: Përse ta besojmë Biblën?

Përktheu: Blerina Pasha

Redaktoi: Valbona Luzi

E drejta e botuesit AEM-Misioni Ungjillor, Gjirokastër, Albania, 2008.

Boton: AEM-Misioni Ungjillor, në bashkëpunim me Illyrian Gospel Trust.

Të drejtat e rezervuara: Asnjë pjesë e këtij botimi nuk duhet të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem, ose të transmetohet nëpërmjet çdo formë apo mënyrë, elektronike, mekanike, fotokopjimi, inçizimi, apo ndonjë mënyrë tjetër pa marrë leje me shkrim nga botuesi.

Citimet Biblike janë marrë nga Bibla, "Diodati i Ri," (1991-1994). E drejta e autorit © SHOQERIA BIBLIKE SHQIPTARE (A.B.S) TIRANË. E përdorur me leje.

Shtypur: Vernon Publishing,

Tirana, Albania, 2008

Tirazh: 2,000 kopje

ISBN: 978-99943-55-19-8

Përse ta besojmë Biblën?

Përgatitja e skenës

Agjentët e qeverisë kishin rënë në gjurmët e tij për shumë vite, por ai kishte arritur gjithmonë t'i shmangte ata, duke ndryshuar adresat njëra pas tjetrës, nën mbulimin e errësirës dhe me ndihmën e shokëve që ndienin keqardhje për të, por rrjeta po ngushtohej...

I motivuar nga një pagesë e majme nga e cila shpresonte të fuste në xhep një shumë të mirë si shpërblim, një agjent special u regjistrua në një universitet lokal, arriti në qarqet që donte dhe, më në fund, zuri shoqëri me shënjestrën e tij. Një ditë, duke u hequr sikur i kishte humbur portofoli, e bindi viktimën që t'i blinte drekën — madje t'i jepte dhe disa para hua — por, kur arritën në vendin e caktuar më parë për të ngrënë, ai u bëri shenjë dy oficerëve që prisnin dhe kështu shoku i tij u arrestua e u dërgua në burg.

Tetëmbëdhjetë muaj më vonë, i rraskapitur dhe i dobësuar nga mbyllja në një qeli të errët dhe të qelbur plot minj dhe parazitë të tjerë, i burgosuri doli në gjyq. Çdo gjë tashmë ishte vendosur para se të mblidhej gjyqi, prandaj dënimi ishte një përfundim i ditur me kohë. Dy muaj më vonë atë e çuan në portën jugore të qytetit, ku një pirg i madh drunjsh, në formën e një kryqi, ishte ngritur në një vend të hapur. Një zinxhir i gjatë varej nga maja dhe një nyje ishte kaluar përmes një vrimë në drejtim vertikal. Para një turme njerëzish që ia kishin ngulur sytë, ku ndodheshin edhe figura publike, këmbët e të burgosurit i lidhën në pozicionin vertikal, zinxhirin e hekurt ia shtrënguan në qafë dhe nyjen ia kaluan në fyt.

Ata vendosën pirgje drunjsh rreth tij dhe pastaj ekzekutuesi bëri një hap para. Ai tërhoqi nyjen dhe trupi që nxirrte frymën e fundit varej në

kryq. Një nga figurat publike ndezi eshkën, pastaj bëri prapa me të tjerët që të shihnin tek digjej viktimat e tyre. Pasi kishin parë për disa çaste, një oficer u urdhërua ta priste trupin që të binte në zjarrin shkumbues. Shfaqja mbaroi dhe spektatorët u larguan për të vazhduar me punët e tyre.

Kjo ndodhi një mëngjes herët, në tetor 1536 (askush nuk është i sigurt për datën e saktë), në oborret e kështjellës Vilvorde, gjashtëdhjetë kilometra në veri të Brukselit. Emri i viktimës ishte William Tyndale — por çfarë krimi kishte bërë ai? Tradhti? Kërcënim të sigurisë kombëtare? Puç për rrëzimin e qeverisë? Terrorizëm? Vrasje të shumëfishtë? Asnjë prej këtyre. Zyrtarisht, lista e gjatë e akuzave thuhej se arrinte deri në akuzë për herezi, por, e zhveshur nga sofizmat, “krimi” kryesor për të cilin Tyndale e dëbuan nga vendi dhe në fund e gjurmuan deri në vdekje ishte: *ai përktheu një libër nga hebraishtja dhe greqishtja në anglisht*. Ai nuk ishte libër që nxiste anarki, okultizëm, trazirë, dhunë apo ndonjë gjë tjetër që kishte të ngjarë të kishte një ndikim të keq në jetët e njerëzve. Përkundrazi, ai lartësonte qeveri të qëndrueshme, drejtësi, paqe, integritet dhe gjithë virtytet që do të donim të gjenim në shoqëri. Libri në fjalë ishte Bibla.

Historia e Tyndale është e tmerrshme, por unike, dhe me siguri mund të themi se nuk ka libër në histori që është urreyer kaq shumë, nuk është përfolur dhe sulmuar kaq shumë. Në shek. IV perandorët romakë Diokleciani dhe Juliani urdhëruan ushtarët e tyre të shkatërronin çdo kopje që mund të gjenin. Më 1382 përkthimi i parë fare në anglisht u ndesh me kundërshtim keqdashës dhe leximi i tij ndalohej me ligj. Kur kopjet e para të punës së Tyndale u sollën kontrabandë në Angli, ato u shkatërruan si “mallra të dëmshme”. Në vende të ndryshme atë e kanë djegur dhe ndaluar, ndërsa përkthyesit e saj janë përndjekur, torturuar dhe vrarë. Kohët e fundit regjimet marksiste, të cilat një herë e një kohë mbizotëruan një të tretën e popullsisë së botës, ngritën sulme masive kundër Biblës, duke shkatërruar me miliona kopje në çdo vend që ata qeverisnin. Madje edhe sot, në epokën e ashtuquajtur tolerantë, Bibla mbetet shënjestër abuzimi dhe zemërate. Në disa vende është një shkelje kriminale ta shesësh ose ta shpërndash atë. Zbrit nga avioni me një Bibël në dorë në këto vende dhe do ta gjesh veten në burg para se të arrish në zyrat e emigracionit.

Megjithatë, pavarësisht nga shekuj kundërshtimi të hidhur, numri i

plotë i Biblave në dispozicion as nuk mund të imagjinohet. Nga 1997 deri në fund të vitit 2002, Shoqëritë e Bashkuara biblike shpërndanë më shumë se 2,979,000,000 kopje të plota ose jo të Biblës.

Edhe shifrat e përkthimit janë po aq mbresëlënëse. 200 vjet më parë Bibla, ose pjesë të saj, ishte në dispozicion në gjashtëdhjetë e tetë gjuhë; nga fundi i 2002-shit kjo shifër kishte arritur në 2,203. Këto përkthime sigurojnë për 90% të popullsisë së botës dhe kanë filluar projekte përkthimi në më shumë se 600 gjuhë të tjera, nga të cilat mbi 500 prej tyre për herë të parë.

Të gjitha këto fakte na ftojnë qartë për të bërë disa pyetje. Përse libri më i përbuzur në botë të kërkohet kaq shumë? Çfarë lloj publikimi mund të prodhojë reagime kaq të ndryshme? Ka vetëm një mënyrë për ta zbuluar...

Faktet

Po të flasim drejt, Bibla nuk është vetëm një libër, por një përmbledhje prej gjashtëdhjetë e gjashtë dokumentesh të mbledhura për një periudhë kohore prej rreth 1 500 vjetësh, ku më të fundit datohen aty nga viti 95 pas Krishtit. Fjala “Bibël” mbështet në fjalën greke “biblos”, që është lëvorja e brendshme e bimës së papirusit. Egjiptianët përdorën papirusin si material për të shkruar, gjerësisht për shkak se ishte relativisht e lirë për ta prodhuar dhe mund të mblidhej rrotull në shirita të mëdhenj. Biblos, së fundi, mori kuptimin e një rrotulle të shkruar, vëllimi ose libri. Nuk ka asgjë fetare apo frymërore në fjalën “Bibël”.

Bibla ndahet në dy pjesë: në Dhiatën (testament) e Vjetër dhe të Re. Një “testament” (ose “besëlidhje”) është një marrëveshje solemne dhe detyruese. Këto dy besëlidhje tregojnë në dy mënyra të dallueshme nga njëra-tjetra, por jo kundërshtuese, vendosmërinë e Perëndisë që t’i vendoste njerëzit në një marrëdhënie të drejtë me të. Nëse kuptojmë këtë, kjo do të shmangë gabimin e të menduarit se Dhiata e Vjetër është jashtë mode ose që Dhiata e Re është “Plani B”. Sigurisht që ka një ndarje në *kohë* ndërmjet dy dhiatave (ka një boshllëk prej 400 vjetësh ndërmjet tyre), por nuk ka ndarje në *temë*. Të dyja besëlidhjet janë në

marrëveshje të plotë për cilësitë dhe karakterin e Perëndisë, natyrën e njeriut dhe mënyrën me anë të së cilës mund të përjetojmë realitetin e pranisë dhe pushtetit të Perëndisë në jetët tona. Besëlidhja e Vjetër dhe e Re janë si dy gjysma të një fjalie: të dyja janë të rëndësishme para se të marrim gjithë kuptimin. Mund të fillojmë të largojmë disa konceptime të gabuara rreth Biblës duke radhitur disa fakte themelore që disa prej kritikëve të saj (dhe disa prej mbështetësve të saj) nuk i kanë kuptuar asnjëherë.

Së pari, në versionet perëndimore të Biblës të *gjashtëdhjetë e gjashtë dokumentet*, (do t'i quaj libra nga ky çast e tutje), nuk janë renditur sipas rendit kronologjik. Për shembull, në Bibël, ashtu siç e kemi tani, Hosea vjen katër libra pas Jeremias, por u shkruajt 150 vjet më parë se ai, dhe Jakobi është libri i tetë nga fundi i Biblës, edhe pse, përveç shtatë apo tetë prej tyre, mund të jetë më i hershëm se njëzet e gjashtë librat e Dhiatës së Re. Megjithatë, libri i parë dhe i fundit janë në vendet e duhura, ndërsa i pari (Zanafilla) fillon me një përshkrim se si çdo gjë, përveç Perëndisë, u krijua — duke përfshirë kohën, hapësirën dhe materien — kurse i fundit (Zbulesa) na çon përtej së ardhmes në përjetësi.

Së dyti, *ato nuk u shkruan në të njëjtën gjuhë*. Shumica ishin në hebraisht, shumë ishin në greqisht dhe pak në aramaisht, një version i gjuhës afro-aziatike që përdoret ende sot.

Së treti, *librat nuk janë të të njëjtit lloj*. Disa janë histori e pastër; të tjerë përqendrohen në ligjin civil ose kriminal; ka pjesë që parashtrojnë rregulla dhe udhëzime rreth çështjeve të ndryshme si adhurimi në tempull dhe pastrimi; disa pjesë janë shkruar si poezi lirike ose fetare; ka porcione të mëdha të një mësimdhënieje të drejtpërdrejtë; ndonjëherë shkrimtarët kanë ndërthur biografi dhe autobiografi; ka korrespondencë personale me individë ose grupe shokësh të së njëjtës mendje; ka poema, histori, fjalime, lutje, himne, predikime dhe, gjithashtu, ajo që është shumë e rëndësishme, ka pasazhe të gjata profecie (do të flasim më vonë për këtë).

Së katërti, në formën e tyre origjinale librat nuk kishin ndarje në kapituj ose vargje. Këto u zhvilluan ngadalë gjatë një periudhe prej 700 vjetësh; Bibla e parë që përmban ndarjet tona të tanishme në kapituj dhe vargje ishte Bibla e Gjenevës, e botuar më 1560.

Sulmet

Bibla nuk sulmohet aq shumë për statistikën, sesa për lëndën që përmban. Herë pas here kam dëgjuar të shkruhet keq për të, si: “plehra”, “mite” ose “folklor”, por ky lloj afrimi ndaj Biblës më kujton shprehjen që përdoret para zgjedhjeve: “E kam mbledhur mendjen. Ju lutem, mos më ngatërroni me fakte”. Sulme të tjera jo vetëm që janë më specifike, por, në shikim të parë, duket se japin një çështje të drejtë. Ne duhet të përballemi me to, prandaj në këtë pjesë do të shohim disa prej tyre, duke filluar me ato që bëjnë pyetje themelore rreth tekstit të plotë biblik.

Kopje me gabime?

Sulmi i parë bën pyetjen: “Nga e dimë që teksti i Biblës së sotme është njësoj si origjinali?” Kjo është një pyetje tërësisht e drejtë. Librat origjinalë u shkruajtën të gjithë me dorë në materiale që prisheshin dhe, deri në kohën që u shpik shtypshkronja në shek. XV, gjithçka që kishim ishin dorëshkrime të kopjuara me dorë, herë pas here, për më shumë se qindra vite. Nga e dimë se këto kopje ishin si origjinalët? Ka të paktën tri prova të rëndësishme që mund të bëjmë mbi Biblën — dhe dokumente të tjera të lashta.

Së pari, *me sa dokumente duhet të punojmë?* Rrotullat e famshme të Detit të Vdekur, të zbuluara nga viti 1947 e në vazhdim, i shtuan 100 rrotulla dokumenteve të Dhiatës së Vjetër ekzistuese, ndërsa kemi mbi 5,000 dorëshkrime të materialit të Dhiatës së Re në greqishten e asaj kohe dhe një shumë prej 20,000 burimesh që na ndihmojnë t’i bashkojmë ato. Vepra të tjera të lashta as nuk mund të krahasohen me to. Kemi vetëm nëntë ose dhjetë kopje të veprës së famshme të Cezarit “*Lufta Galike*” (58 – 50 para Krishtit), njëzet kopje të “*Historia Romake*” e Livit (59 para Krishtit – 17 pas Krishtit), shtatë kopje të historive të Plinit të Riut (61 – 113 pas Krishtit) dhe vetëm dy kopje të “*Histori dhe Anale*” nga Taciti (55 – 120 pas Krishtit). Rivali që i afrohet më shumë burimeve të Dhiatës së Re është “*Iliada*” e famshme e Homerit, vetëm me 643 kopje.

Bibla e fiton lehtësisht garën e numrave, por kjo na çon në një provë të dytë: *sa i afrohen në kohë dorëshkrimet që kemi teksteve origjinale?* Në rastin e Biblës dorëshkrimet më të vjetra kryesore janë shkruar rreth

300 vjet më pas, megjithatë dy papiruse të rëndësishme janë shkruar 100 vjet pas origjinalit, i famshmi “*Fragmenti i John Rylands*” mendohet të jetë shkruar midis viteve 117 – 138 pas Krishtit dhe tri fragmente të vegjël papirusi në Kolegjin Magdalen në Oksford datojnë që nga çereku i tretë i shekullit të parë. Kritikët tregohen të shpejtë të kapen pas këtyre boshllëqeve në kohë, si arsye për ta hedhur poshtë Biblën, megjithatë mbyllin sytë para boshllëqeve akoma më të mëdha në kohë për dokumente të tjera të cilat janë pranuar pa diskutim. Vetëm një kopje e “*Historia Romake*” e Livit është shkruar rreth 400 vjet pas origjinalit; me veprat e Plinit të Riut boshllëku është prej 750 vjetësh; nga Taciti nuk kemi asgjë më të afërt se ajo që është shkruar pas 900 vjetësh; dhe dorëshkrimi më i vjetër ekzistues i “Lufta Galike” e Cezarit daton 1,000 vjet pas ngjarjeve që ajo përshkruan.

Asnjë pjesë tjetër e letërsisë së lashtë, fetare ose jo, mund t’u afrohet letrave kredenciale të Biblës në këtë fushë. Kohët e fundit vizitova mbetjet e murit të Hadrianit, që është i gjatë rreth 111 kilometra përmes një vendi të hapur ndërmjet Solway Firth dhe grykës së lumit Tyne, afër kufirit verior të Anglisë. Asnjë nuk e vë në pikëpyetje faktin që në vitin 122 pas Krishtit perandori Hadrian urdhëroi ndërtimin e murit për të shënuar atë që në atë kohë ishte shtrirja më e largët e Perandorisë Romake — dhe “për të ndarë romakët nga barbarët”. Po ashtu, askush nuk e vë në pikëpyetje faktin që një nga pararendësit e Hadrianit, Jul Cezari, e pushtoi Britaninë për herë të parë në vitin 55 para Krishtit, e megjithatë tani kemi vetëm nëntë ose dhjetë dorëshkrime për të mbështetur këtë dhe më i hershmi prej tyre daton 900 vjet pas ngjarjes.

Përsëri Bibla i lë shumë mbrapa rivalët e saj. Ashtu si ka thënë dikur Sër Frederic Kenyon, dikur drejtor dhe punonjësi kryesor i Muzeut Britanik: “Nuk ka rast tjetër kur intervali kohor ndërmjet hartimit të librit dhe datës së dorëshkrimit më të hershëm ekzistues është kaq i shkurtër ... dhe themeli i fundit për ndonjë dyshim mbi faktin se Shkrimet kanë ardhur deri te ne ashtu si u shkruajtën është hequr. Si *vërtetësia ashtu dhe integriteti i përgjithshëm i Dhiatës së Re mund të konsiderohen si përfundimisht të themeluara*”¹ (theksi që u është dhënë këtyre fjalëve është i shtuar).

Prova e tretë është në njëfarë mënyre më e rëndësishmja: *si mund të sigurohemi se dorëshkrimet u kopjuan në mënyrë të saktë?* Përsëri mund të themi se kjo është një pyetje përsosmërisht e drejtë, por, para se t’i

përgjigjemi, ia vlen të vëmë në dukje se as shtypshkrimi nuk i eliminon gabimet. Një version, i botuar më 1631, njihet si “Bibla e ligë”, sepse fjala “nuk” ishte hequr nga urdhërimi: “Nuk do të bëni tradhti bashkëshortore”. Më 1717 një tjetër u bë e njohur si “Bibla e uthullës”, sepse një pasazh ishte titulluar “Shëmbëlltyra e uthullës” në vend të “Shëmbëlltyra e vreshtit” (vërejmë që në anglisht fjalët për uthull, “vinegar”, dhe vresht, “vineyard”, janë pak a shumë të ngjashme kur shkruhen). Unë kam ende një Dhiatë të Re në të cilën marinarët, në përpjekje për të shpëtuar anijen gjatë një stuhie, thuhet se kanë “*liruar rripat prej gome*”, në vend që të thuhej “rripat e timonit” (po ashtu fjalët në anglisht për “gomë” dhe “timon” janë respektivisht “rubber” dhe “rudder”, të cilat mund të ngatërrohen lehtësisht).

Pyetja më e rëndësishme është: nëse gjatë shekujve të kopjimit me dorë u bënë kaq shumë gabime, sa mund t’i zëmë besë tekstit që kemi. Nuk ka hapësirë këtu për të hyrë në hollësi, por kujdesi shumë i përpiktë me të cilin judenjtë kopjuan Shkrimin e tyre të shenjtë dhe mbrojtësit e ndërlikuar që vendosën në përpjekje për të eliminuar gabimet pothuajse e sfidojnë besimin. Si rezultat, dorëshkrime që datojnë me qindra vite larg njëri-tjetrit janë në mënyrë të habitshme të njëjtë. Po japim një shembull. Dorëshkrimi i rrotullës së Detit të Vdekur i një kapitulli veçanërisht të rëndësishëm në Bibël është më shumë se 1,000 vjet më e vjetër se kopja më e hershme që zotëronim më parë, e megjithatë nga 166 fjalët e saj vetëm një (me tri gërma) është në dyshim, dhe kjo fjalë nuk bën ndonjë ndryshim në kuptimin e pasazhit. Asnjë dokument tjetër i lashtë nuk i afrohet kësaj shkalle të mahnitshme qëndrueshmërie. Te “*Mahabharata*”, vepra kombëtare epike e Indisë, rreth 10 % e rreshtave kanë gabime,² ndërsa “*Iliada*” e Homerit ka njëzet herë më shumë shembuj se Bibla, ku fjalët e origjinalit janë në dyshim.

Kjo është tepër domethënëse, ashtu si e ilustron edhe autori britanik Brian Edwards: “Mendoni sikur pesë fëmijëve t’u kërkohej të kopjonin një fjali nga dërrasa në shkollë dhe vetëm dy të kishin kopje identike. Po të mos e dinim fjalinë origjinale, nuk mund të ishim të sigurt nëse ata të dy kishin të drejtë ose nëse ata bënë të njëjtat gabime rastësisht. Por, nëse 500 nxënës do të kopjonin fjalinë dhe dyqind prej tyre do të kishin shkruar njësoj, do të ishim tërësisht të sigurt se ata e përfaqësonin saktësisht origjinalin”.³ Megjithatë, në 100 rrotulla që paraqesin të gjitha veç njërit prej 39 librave të Dhiatës së Vjetër dhe rreth 20,000 fragmente

të Shkrimit të kopjuara në një periudhë prej mbi 1,000 vjet kemi vetëm ndryshime të papërfillshme. Sër Frederic Kenyon nuk kishte asnjë dyshim për kuptimin e kësaj: “Nuk mund të mbrohet shumë fort, se në substancë *teksti i Biblës është i sigurt: sidomos me rastin e Dhiatës së Re*. Numri i dorëshkrimeve dhe të citimeve prej saj nga shkrimtarët më të vjetër në kishë është kaq i madh, sa praktikisht është e sigurt se leximi i vërtetë i çdo pasazhi të dyshimtë është ruajtur në njërën prej këtyre doërskrimeve të lashta. Kjo nuk mund të thuhet për ndonjë libër tjetër të lashtë në botë”.⁴

Mrekullitë

Në shekullin e tetëmbëdhjetë skeptiku skocez Davide Hume filloi një sulm të dhunshëm mbi mrekullitë. Në thelb, argumenti i tij ishte se ligjet e natyrës mbështeteshin në shkallën më të lartë të probabilitetit, ndërsa mrekullitë kishin shkallën më të ulët të probabilitetit; prandaj gjëja më e mirë ishte të mos besojë te mrekullitë. Ai, madje, vazhdoi të thoshte se mrekullia e vetme ishte që *kushdo* mund të besojë në to! *Fjalori i Chambers* e përshkruan mrekullinë si “një ngjarje ose veprim që thyen një ligj të natyrës”,⁵ prandaj për shumë njerëz kjo e vulos rastin: *në mungesë të Perëndisë*, çdo gjë që duket se bie në kundërshtim me ligjet shkencore që qeverisin botën tonë të kohës dhe hapësirës nuk mund të jetë e vërtetë dhe duhet të ketë ndonjë shpjegim tjetër. Vëreni fjalët që kam theksuar! Me ta përjashtuar Perëndinë nga tabloja, ngjarjet e klasifikuara si mrekulli mund të katandisen si “mistere” ose “që të çojnë në drejtim të gabuar” dhe duke qenë se fjalët që e hapin Biblën janë: “Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën”,⁶ do të bënte që Bibla të kishte fillimin më të keq.

Një shkrimtar ka identifikuar 232 mrekulli biblike,⁷ por kjo nuk e jep tablonë e plotë, sepse Bibla thotë se shumë të tjera nuk janë regjistruar. Nëse mrekullitë nuk ndodhën asnjëherë, atëherë Bibla do të shkatërronte veten, por përafrimi i duhur nuk është të fillojmë duke e menduar përgjigjen më parë, por duke pyetur: “A ndodhën *vërtet* mrekullitë?”, dhe pastaj të shqyrtojmë secilin rast në dritën e dëshmisë. Nëse një dëshmi çon në një mrekulli, ajo kërkon një shpjegim, kështu që ta përjashtosh Perëndinë para se të konsiderosh se ai mund ta sigurojë këtë nuk tregon as mençuri, as zgjuarsi.

Të përjashtosh mrekullitë si jo-ngjarje, sepse janë kundër ligjeve të natyrës, mund të duket diçka tepër “shkencore”, por e vërteta është krejtësisht e kundërt. Ligjet e natyrës asnjëherë nuk shkaktojnë asgjë; ato janë vlerësimi ynë se si gjërat ndodhin normalisht, prandaj personi që beson te Perëndia pohon se ato përshkruajnë *atë që Perëndia bën të ndodhë normalisht*. Çështja e mrekullive nuk është aspak çështje shkencore, por teologjike. Nëse Perëndia ekziston dhe përcakton ligjet e natyrës, ai vetë nuk u nënshtrohet atyre dhe mund t’ia kalojë atyre sa herë që zgjedh të veprojë ashtu.

Në një letër drejtuar gazetës “The Times”, më 1984, trembëdhjetë shkencëtarë të shquar, pjesa më e madhe profesorë universitetesh, heshturazi eliminuan një nga argumentet kryesore mbi çështjen e mrekullive: “Nuk është e vlefshme nga ana logjike që të përdorësh shkencën si argument kundër mrekullive. Të besosh se mrekullitë nuk mund të ndodhin është po aq akt besimi sa të besosh se ato mund të ndodhin ... mrekullitë janë ngjarje pa precedentë. Çfarëdo që mund të sugjerojnë stilet e tanishme në filozofi ose zbulimet nga pyetësorët e bërë, është e rëndësishme të pohojmë se shkenca ... nuk mund të thotë asgjë mbi këtë temë”.⁸ Nëse një person hedh poshtë Biblën për shkak se ajo regjistron mrekulli, tregon se ai as që ka nisur të kërkojë se si qëndron puna me të.

“Por shkenca thotë ...”

Përparimet e bëra nga shkenca dhe teknologjia në 200 vitet e fundit kanë qenë mbresëlënëse dhe të ecurit në kreshtën e kësaj dallge të emocionon. Mjekësia, komunikacioni, transporti dhe shumë fusha të tjera të jetës moderne janë transformuar, ndërsa njohuria jonë shkencore rritet dhe teknologjia e shfrytëzon për të na sjellë përfitime të mëdha në jetët tona.

Ky progres i mahnitshëm ka bërë që shumë njerëz të japin pohime të jashtëzakonshme për shkencën. Në librin e tij “*Feja dhe shkenca*” (botuar më 1961), filozofi britanik Bertrand Russell shkruan: “Çfarëdo njohurie që arrihet duhet të arrihet nga mjete shkencore; dhe *atë që shkenca nuk mund ta zbulojë, njerëzimi nuk mund ta dijë*”.⁹ Në një debat mbajtur më 1998 shkollari nga Oksfordi Peter Atkins shkoi edhe më tej duke thënë: “Perëndia nuk është i domosdoshëm, sepse shkenca mund të shpjegojë

çdo gjë”. Nëse pohime të tilla janë të vërteta, atëherë, besueshmëria e Biblës zhytet pa asnjë gjurmë — por a janë ato të vërteta? Të paktën ka katër gjëra që mund të thuhen.

Së pari, *shkenca është një proces i vazhdueshëm mësimi në të cilën me kalimin e kohës gjëra që dikur mendoheshin si të vërteta më vonë ka dalë se nuk kanë qenë të vërteta*. Sër Karl Popper, filozofi më i njohur i shkencës, shkon madje edhe deri atje sa thotë: “Çdo pohim shkencor duhet të mbetet përgjithmonë tentativë”.¹⁰ Në shkencën e vërtetë fjala e fundit nuk është domosdoshmërisht fjala vendimtare.

Së dyti, *shumë gjëra janë përtej arritjes së shkencës dhe të metodës shkencore*. Shkenca nuk mund të na tregojë përse u formua bota, përse ligjet e natyrës janë në vend, përse qeniet njerëzore janë persona dhe jo ashtu si dikush i quajti “kompjuterat të bëra prej mishi”, si të dallojmë të mirën nga e keqja, përse ekziston mendja ose përse kemi një përmasë frymërore. Nuk jep përgjigje për pyetjet më të mëdha të jetës, ato që kanë lidhje me kuptimin dhe qëllimin, vdekjen dhe fatin njerëzor. Përveç kësaj (duke e lidhur direkt me çështjen që po diskutojmë), *shkenca nuk mund ta provojë se Perëndia nuk ekziston*. Madje edhe Peter Atkins u tregua mjaft i ndershëm kur filloi kontributin e tij në debatin e vitit 1998 duke thënë: “Më duhet të pranoj që nga fillimi se shkenca nuk mund të çvërtetojë ekzistencën e Perëndisë”.

Së treti, *asnjë fakt shkencor (në kundërshtim me një teori shkencore) nuk ka vërtetuar se ndonjë pohim biblik është i gabuar*, ndërkohë që shumë pohime të tilla janë dashur të tërhiqen mbrapsht. Le të japim vetëm një shembull. Bibla përmban shumë referime për hitejtë, një popull politeist të cilët pushtuan rajonin që shtrihej nga Palestina e Veriut deri në Eufrat dhe që lulëzuan për shumë shekuj. Kur shumë vite gërmimesh arkeologjike nuk arritën të gjenin ndonjë shenjë prej tyre, skeptikët pretendonin se të dhënat e Biblës ose ishin fantazi, ose folklor — por, më vonë, eksplorimet zbuluan shumë prova që mbështesnin të dhënat e Biblës me detaje dhe një muze në Ankara, në Turqi, i është kushtuar relikeve hiteje.¹¹ Alan Millard, profesor i hebraishtes dhe gjuhëve të lashta semitike në Universitetin e Liverpulit, thotë: “Ne pohojmë se asgjë nuk është gjetur që të mund të vërtetohet se kundërshton ndonjë pohim të Dhiatës së Vjetër. Kërkimi i arkeologjisë është një ndihmë e mirëpritur për një njohuri më të pasur të mesazhit të Biblës”.¹²

Së katërti, *shumë nga shkencëtarët që merren me historinë nuk*

kanë ngurruar ta mbështesin Biblën. Këtu përfshihen fizikanti irlandez Robert Boyle, ati i kimisë moderne; kimisti britanik Michael Faradey, i cili zbuloi induksionin elektromagnetik; astronomin gjerman Johannes Kepler; biologun suedez Carolus Linnaeus, ati i taksonomisë biologjike; fizikantin natyralist suedez James Clerk Maxwell, ati i fizikës moderne, i cili parashikoi i pari ekzistencën e valëve të radios; natyralistin danez Niels Steno, themeluesi i gjeologjisë moderne; dhe fizikantin skocez William Thomson, i cili krijoi Shkallën Kelvin të temperaturave absolute. Citime nga dy gjigantë të tjerë të shkencës bëjnë që të pranohet ideja e tyre. I pari është Sër Francis Bacon, filozof, politikan, dhe, së fundi, Lord Kancelar, i cili pati një ndikim të fuqishëm në qarqet shkencore, sidomos kur propozoi një teori të re të teorisë shkencore që u bë e njohur si metoda shkencore, e cila e vinte theksin në rëndësinë e vëzhgimit dhe eksperimentit. Si një studiues i devotshëm i Biblës Bacon shkroi: “Ka dy libra që qëndrojnë para nesh për t’i studiuar, që të mos lejojnë të biem në gabim; i pari është vëllimi i Shkrimeve i cili zbulon vullnetin e Perëndisë; pastaj është vëllimi i krijesave [Bacon nënkuptonte botën natyrore] e cila shpreh fuqinë e tij”.¹³ I dyti është matematikani dhe fizikani britanik Sër Isaac Newton, i cili u zgjodh president i Shoqërisë Mbretërore për njëzet e katër vite me radhë, i pari person që iu dha titulli kalorës për shërbimet e tij në shkencë dhe i njohur më shumë për zbulimin e ligjit të rëndesës universale. Ashtu si Bacon edhe ai ishte gjithashtu një studiues i pasionuar i Shkrimeve dhe pas shumë vitesh studimi të kujdesshëm arriti në përfundimin se Bibla ishte “një shkëmb nga i cili të gjithë çekiçët e kritikës nuk kanë shkëputur asnjëherë asnjë fragment të vetëm”.

Sot me mijëra shkencëtarë — vetëm Shoqata Shkencore Amerikane ka mbi 2,500 anëtarë, shumë prej tyre të famshëm në disiplinat që kanë zgjedhur, janë tërësisht dakord me këta gjigandë të së shkuarës dhe nuk e kanë problem të pajtojnë njohurinë e tyre shkencore me Shkrimin. Të thuash se shkenca e ka vërtetuar si të gabuar Biblën është si të notosh kundër një rryme të fuqishme të dëshmisë inteligjente.

E pamundur ta prekësh?

Miliona njerëz ndjekin këtë vazhdë, duke e hequr Biblën mënjanë sikur nuk ka lidhje me botën tonë moderne, por habitem që dikush duhet ta bëjë këtë, sepse Bibla është në titujt e medias së sotme.

Për shembull, Bibla ka shumë për të thënë, drejtpërdrejt ose jo, rreth martesës, divorcit, rimartesës, alkoolizmit, abuzimit me substanca, stresit dhe depresionit. Ajo u flet emocioneve më dëmtuese për njeriun, si: zemërimit, fajit, frikës, dyshimit e ankthit dhe dënon pandershmërinë, imoralitetin, arrogancën, lakminë, egoizmin dhe ndyrësinë. Ajo u drejtohet çështjeve të tilla, si: dhunës, vrasjes, luftës dhe shkatërrimeve natyrore. A janë këto gjëra që nuk kanë lidhje me ne? Ajo vë në dukje parime të qarta që lidhen me çështje etike dhe morale sot, siç janë aborti, eutanazia, homoseksualiteti, klonimi njerëzor dhe forma të tjera të inxhinierisë gjenetike. A nuk janë këto çështje bashkëkohore?

Bibla mëson gjerësisht mbi jetën familjare të qëndrueshme, kënaqësinë e duhur të seksit, përgjegjësitë e punëtorëve dhe të punëdhënësve, drejtësinë shoqërore, integritetin e biznesit dhe të ardhurat personale. Tregon se si të merremi me varfërinë, sëmundjet, përbuzjen, vdekjen dhe traumat e tjera personale. Duke e cituar drejtpërdrejt nga Bibla, ajo gjithashtu tregon rrugën për të “dashuria, gëzimi, paqja, durimi, mirësia, besnikëria, butësia dhe vetëkontrolli”.¹⁴ A janë këto gjëra që nuk kanë rëndësi për ne?

Ajo i drejtohet drejtpërdrejt mirëqenies së kafshëve dhe kujdesit ndaj ambientit. Ajo flet fuqishëm për “të pasurit” e “të mospasurit” dhe thekson detyrën tonë për të ndihmuar të sëmurët, të pamundurit, të vuajturit, të varfrit, të pastrehët dhe të shpronësuarit, duke folur ndonjëherë në veçanti për të vejat dhe jetimët. A mund ta heqim këtë gjë mënjanë?

Në librin e tij të bukur *“Hir — Hir i mahnitshëm”* Brian Edwards jep një shembull befasese se sa shumë udhëzime jepen në Bibël për jetën: “Ligji i Përtërirë 22 është një kapitull në Dhiatën e Vjetër që merret me pasurinë e humbur, fqinjësinë, me mosshkëmbimin e rrobave midis burrave dhe grave, ekologjinë, shëndetin dhe sigurinë, bujqësinë dhe kopshtarinë, marrëdhëniet martesore, tradhtinë bashkëshortore dhe dhunën”. Pastaj ai bën pyetjen: “A po sugjerojmë vërtet se nuk ka asgjë që ... bota moderne të mësojë në një pasazh të tillë?”¹⁵

Ndonjëherë kritikët e dënojnë Biblën si më shumë “negative” se ndërtuese, por ky është një kontrast i remë. Për shembull, është e vërtetë se tetë nga dhjetë urdhërimet e famshme¹⁶ fillojnë me fjalët: “Nuk do të”, por a do të thotë se ato nuk janë ndërtuese? Mendoni sikur një doktor shkruan në recetë disa ilaçe shumë të fuqishme për një sëmundje të rëndë, saqë receta kërkon që të merret një prej tyre për tridhjetë ditë dhe

se në etiketën e ilaçit shkruhet qartë: “Është e rrezikshme po të marrësh më shumë se duhet”. Pa dyshim që ky është një urdhër negativ dhe farmacisti fare mirë mund ta nënvizojë këtë duke të të paralajmëruar se një mbidozë mund të jetë vdekjeprurëse. Po të vendosje se prania jote në punë ishte aq e rëndësishme sa të shpërfillje paralajmërimet dhe t’i pije të tridhjeta ilaçet sapo të shkoje në shtëpi, atëherë ti do të mungojë në punë përgjithmonë! Urdhërimi negativ nuk kishte për qëllim të të dëmtonte, por të bënte të kundërtën — prandaj është e njëjta gjë edhe me dhjetë urdhërimet. “Nuk do të vrasësh” është mohore, por bindja ndaj saj mbron jetën njerëzore; “Nuk do të kryesh tradhti bashkëshortore” është mohore, por bindja ndaj saj mbron shenjtërinë e martesës; “Nuk do të vjedhësh” është mohore, por t’i bindesh asaj ruan pronën personale; “Nuk do të bësh dëshmi të rreme” është mohore, por bindja ndaj saj ruan integritetin në marrëdhëniet tona me të tjerët.

Bibla shkon edhe më tej. Ajo ngre pyetjet më të mëdha që kemi ndeshur ndonjëherë si qenie njerëzore. Drejt fundit të jetës së tij artisti i njohur francez Pierre Gauguin, i cili jetonte në Tahiti (ku pikturoi një tablo të madhe për të cilën tha se përfaqësonte testamentin e tij të fundit), shkroi në cepin e majtë në krye (në frëngjisht): “Nga vijmë? Çfarë jemi? Ku po shkojmë?” Në dëshpërim për të gjetur përgjigjet ai u përpoq të kryente vetëvrasje para se të vdiste në agoni pesë vjet më vonë nga ndikimet e një sëmundjeje seksualisht të transmetueshme. Gauguin bëri pyetjet e duhura, por nuk i gjeti asnjëherë përgjigjet, e megjithatë Bibla i jep ato në mënyrë të qartë dhe të arsyeshme. Pa lidhje? Aspak! Asnjë libër që është shkruar ndonjëherë nuk i afrohet mënyrës në të cilën Bibla i flet jetës në shekullin XXI.

Rrugë të tjera për në mal?

Një argument tjetër i zakonshëm për të hedhur poshtë Biblën është të thuash se ka vetëm një në mes shumë “shkrimeve të shenjta” dhe se ato mund të jenë njësoj të vlefshme. Megjithatë edhe një ateist i pasionuar si Bertrand Russell e shtypi këtë ide: “Mendoj se të gjitha fetë e mëdha në botë — Budizmi, Hinduizmi, Krishterimi, Islami dhe Komunizmi — janë si të pavërteta ashtu edhe të dëmshme. Është e qartë nga ana logjike se, përderisa ato nuk bien dakord, jo më shumë se një prej tyre mund të jetë e vërtetë”.¹⁷

Fjala e fundit e Russell i bie çështjes tamam në kokë, sepse fetë kryesore të botës përkufizohen jo nga ngjashmëritë e tyre, por nga ndryshimet e tyre. Ato mund të bien dakord mbi mënyrën se si të merren me çështje të caktuara shoqërore dhe morale, por janë aq larg mbi çështjet më të rëndësishme dhe, mbi të gjitha, mbi natyrën e vetë Perëndisë. Në mësimin e krishterë Perëndia i vetëm i vërtetë ekziston në tre persona të barabartë nga ana hyjnore dhe natyra e tij në thelb është dashuri, ndërsa Perëndia i Islamit është njëjës dhe i largët; ai i Sikizmit është i largët dhe jopersonal. Hinduizmi thotë se ka me miliona perëndi; Zoroastrianizmi thotë se ka dy perëndi dhe në Budizëm nuk ka asnjë perëndi. Si mund të jenë gjithë këto fe “shtigje të ndryshme drejt së njëjtës majë”, ashtu si pohojnë shumë njerëz, përdërisa nuk bien dakord mbi natyrën e majës? Në vitin 1996 princi Çarls njoftoi se në ngjarjen e ngjitjes së tij në fronin britanik ai do ta shihte veten si “mbrojtës besimi” më shumë sesa “mbrojtës i besimit”, por ashtu si Janet Daley e “*Daily Telegraph*” vuri në dukje: “Nuk mund të mbroni të gjitha besimet — të paktën, jo në të njëjtën kohë — sepse secili ka besime që i bën ato të të tjerëve të rreme”.¹⁸ Për të njëjtën arsye, nuk është logjike të barazosh Biblën me “shkrime të tjera të shenjta”.

Gabime?

Një miku im i dërgoi vëllait të tij, një ateist militant, një prej librave të mi, duke shpresuar se mund të ndikonte tek ai që të ndryshonte pozicionin e tij. Përgjigjja që ai mori fillonte: “Çdo gjë që Blanchard shkruan është një mal me plehra, budallallëqe, broçkulla dhe gjepura krye e fund”. Nuk mund të them se jam i pagabueshëm, por mendova se këto fjalë ishin vërtet të forta. Çfarë mund të thuhet për ata që e sulmojnë Biblën në të njëjtën mënyrë?

Unë, zakonisht, filloj duke thënë: “Nëse është plot me gabime, eja pas një ore dhe më trego ca prej tyre”. Deri tani asnjë nuk i është përgjigjur sfidës. Kjo është goxha e habitshme, sepse një prej shumë gjërave të shënuara rreth Biblës është mënyra se si pohimet e saj konfirmohen nga dëshmi të jashtme. Edhe pse Bibla nuk është libër historie, ajo përmban shumë të dhëna historike dhe, *sa herë që ka qenë e mundur për ta kontrolluar këtë ndaj dëshmimeve bashkëkohore, është gjetur se Bibla ka qenë e saktë*. Nuk ka hapësirë këtu për ta zhvilluar këtë temë, por katër ekspertë të shquar do të na ndihmojnë të vendosim drejt të dhënat.

Robert Dick Willson, që dikur ka qenë profesor i Filologjisë Semitike (gjuha dhe letërsia e Lindjes së Mesme) në Seminarin Teologjik Princeton në Amerikë, u ul në një program studimi të pabesueshëm prej dyzet e pesë vjetësh duke u përqendruar sidomos në materialin e Dhiatës së Vjetër. Pas kërkimeve tepër të lodhshme në të dhënat e Biblës, për rreth dyzet mbretër që kishin jetuar për një periudhë prej 1,600 vjetësh, arriti në përfundimin se, ndërsa kishte gabime në vendet e tjera ku ishin regjistruar po këto të dhëna, informacioni i Biblës ishte i përsosur dhe se “matematikisht ka një mundësi në 750,000,000,000,000,000,000,000 që kjo saktësi të jetë rrethanë e thjeshtë”.¹⁹ Duke e peshuar mirë këtë, ai shtoi: “Nuk ka dëshmi më të fortë për saktësinë e mjaftueshme të të dhënave të Dhiatës së Vjetër që mund të imagjinohet, sesa këto të dhëna për mbretërit”.²⁰

William F. Albright, i njohur si eksperti më i madh në botë në studimet orientale, ishte drejtori i Shkollës Amerikane për kërkime orientale në Universitetin Johns Hopkins, autori i mbi 800 librave dhe artikujve, si dhe ai që verdikti i të cilit konfirmoi vërtetësinë e Rrotullave të Detit të Vdekur. Më 1958 ai shkroi: “Falë kërkimit modern tani pranojmë historicitetin e saj të mjaftueshëm. Tregimet për patriarkët, për Moisiun dhe eksodin, për pushtimin e Kananit, për gjyqtarët, monarkinë, mërgimin dhe ripërtëritjen, janë konfirmuar dhe ilustruar të gjitha deri atje sa unë do ta mendoja të pamundur dyzet vjet më parë”.²¹

Sër William Ramsay njihet botërisht si një prej arkeologëve më të mëdhenj në botë. Themelues i Akademisë Britanike, në fillim ai vazhdonte me idenë e kohës se Dhiata e Re kryesisht ishte më shumë mitologji, sesa një e dhënë historike e saktë dhe bashkëkohore. Për shembull, ishte i bindur se libri i Veprave, i shkruajtur nga autori i ungjillit sipas Lukës, një doktor i shekullit të parë, nuk ishte më tepër se folklor, i farkuar nga një tregimtar anonim shekuj më pas se ngjarjet që pretendonte se kishte regjistruar. Megjithatë, pas kërkimit të kujdesshëm Ramsay u bind se informacioni i Lukës ishte kaq shumë i saktë, saqë duhet të pranohet si “një historian i nivelit të parë, i cili duhet të vendoset bashkë me historianët më të mëdhenj”.²²

Nelson Glueck, arkeologu kryesor i gjërave të përshkruara në Bibël, gërmoi mbi 1,000 vende në Lindjen e Mesme, duke përfshirë edhe minierat e bakrit të mbretit Solomon dhe portin e lashtë të Detit të Kuq të Ezon Geber. Pas shumë vitesh kërkimi të kujdesshëm, ai shkroi për

“kujtesën historike të Biblës që ishte në mënyrë të mahnitshme e saktë dhe veçanërisht kur fortifikohet nga fakti arkeologjik” dhe shkoi deri atje sa të thoshte: “Mund të pohohet kategorikisht se *asnjë zbulim arkeologjik nuk ka kundërshtuar ndonjëherë ndonjë referim biblik*”.²³

Këto janë dëshmi të klasit botëror dhe, nëse nuk vërtetojnë për vete se çdo pohim historik në Bibël është i vërtetë, ato e kthejnë në budallallëk pohimin e thënë në mënyrë të pakujdesshme se Bibla është “plot me gabime”.

Kontradikta?

Një variant i sulmit të mëparshëm është të thuash se Bibla është plot me kontradikta. Nga datat te doktrina, nga gjeografia te gjenealogjia dhe nga emrat te numrat, kritikët kanë thënë se Bibla shpesh bie në kundërshtim me veten, prandaj mund të hidhet poshtë në çast, por akoma nuk kam takuar ndonjë që të jetë në gjendje ta vërtetojë këtë. Nga shumë prej kontradiktave këtu janë disa shembuj bashkë me përgjigjet që mund t’u jepen atyre.

1. Josia, mbreti i Judës, thuhet të ketë “ecur si babai i tij Davidi”,²⁴ dhe ne e dimë se Josia nuk ishte biri i Davidit, por i Amonit.²⁵ Kjo duket si një kontradiktë e qartë, derisa e kuptojmë se në kohët e Dhiatës së Vjetër ishte zakon për historianët që të shkurttonin gjenealogjitë në këtë mënyrë. Në hebraisht nuk ka fjalë për “nip”, prandaj mënyra e vetme për t’iu referuar një nipi, që shumë herë nuk është shprehur, ishte ose të radhitje të gjithë etërit që vinin ndërmjet, ose të mos i shkruaje dhe ta quaje atë “bir”.

2. Biri i mbretit David, Absalomi, thuhet të ketë pasur tre djem,²⁶ por më vonë është shkruar se ai ka thënë: “Nuk kam bij që të mbajnë kujtimin e emrit tim”.²⁷ Kësaj kontradikte të dukshme mund t’i përgjigjemi lehtësisht duke menduar se të tre djemtë kishin vdekur në kohën që Absalomi bëri vajtimin e tij.

3. Jezusi tha se trupi i tij do të shtrihej në varr për “tri ditë e tri netë”,²⁸ por Bibla na thotë se ai u varros ditën që vinte para sabatit jude (një e premte) dhe u ngrit nga të vdekurit ditën e parë të javës (e dielë). Kjo duket se është një e metë serioze, por lë mënjanë çështjen se judenjtë llogaritnin çfarëdo pjese të ditës si “një ditë”, kështu që në

këtë rast kemi një ditë të plotë (e shtunë), pjesë të dy ditëve të tjera (e premija dhe e diela) dhe dy netët e ndërmjetme, zakonisht, do t'i referohej si “tri ditë dhe tri netë”.

4. Një prej shkrimtarëve të Dhiatës së Re thotë se në ditën e parë të Pashkës dy engjëj u shfaqën në varrin e Jezusit,²⁹ ndërkohë që një tjetër përmend vetëm një engjëll.³⁰ Kritikët janë kapur pas kësaj, por logjika vetëm na tregon se po të ishin dy engjëj është matematikisht e sigurt se një ishte. Nëse shkrimtari i dytë do të kishte thënë se ishte vetëm një engjëll, kritikët do të ishin në një pozitë të fortë, por ashtu siç shprehet teksti nuk ua jep atyre këtë mundësi.

5. Bibla thotë se Jezusi do të kthehet një ditë në tokë dhe se në çastin e duhur kur ai të shfaqet “dy njerëz do të jenë në fushë”,³¹ që duket se do të thotë që kjo do të ndodhë gjatë ditës. Megjithatë, në një vend tjetër Jezusi fliste për kthimin e tij sikur të jetë “atë natë”, kur “dy njerëz do të jenë në një shtrat”.³² Ky duket si një gabim i qartë, derisa kujtojmë se mesi i ditës në një pjesë të botës është mesi i natës në një tjetër.

Jo çdo gjë në Bibël është aq e qartë sa drita e ditës dhe jo çdo kontradikte të supozuar mund t'i përgjigjesh kaq lehtë sa këto. Po ashtu nuk do të ishte e logjikshme që të pohojë se gjatë shumë shekujve të kopjimit të Shkrimeve me dorë nuk ka pasur asnjëherë rrëshkitje të penës. Megjithatë, vite studimi të kujdesshëm tregojnë se këto janë të pakta dhe larg njëra-tjetrës, pothuajse tërësisht të kufizuar në gjashtë librat historikë të Dhiatës së Vjetër dhe janë vetëm ndryshime të vogla në numra ose në ndonjë fjalë të rrallë. Po ajo që ka më shumë rëndësi, *as edhe një prej këtyre “rrëshkitjeve të penës” nuk bën një ndryshim material në kuptimin ose domethënien e pasazhit ku ato gjenden.*

Është e nevojshme të thuhet edhe pesë gjëra të tjera para se të përfundojmë këtë seksion të broshurës.

Së pari, *një pyetje pa përgjigje nuk është sikur të jetë vërtetim i një gabimi dhe një problem i pazgjidhur nuk është domosdoshmërisht një gabim.*

Së dyti, kur kritikizmi tekstual ishte në lartësinë e tij rreth 150 vjet më parë, shumë gabime dhe ndryshime të supozuara u gjurmuan, por studimi i kujdesshëm i ka pakësuar ato vazhdimisht dhe teologu amerikan R. C. Sproul pohon: “Sot ka më pak arsye për të besuar se Bibla është

plot kontradikta se në çfarëdo kohe gjatë historisë së kishës”.³³

Së treti, është pranuar për më shumë se 2,500 vjet se, me kualifikime të caktuara, *përfitimi prej dyshimit i duhet dhënë dokumentit për të cilin bëhet fjalë*. Simon Greenleaf, profesor mbretëror i Ligjit në Universitetin e Harvardit, ishte një nga ekspertët më të mëdhenj në botë për provën ligjore. Një herë në jetën e tij ai planifikoi të diskretitonte besueshmërinë e Dhiatës së Re, por në fund arriti në përfundimin se ishte plotësisht e besueshme dhe se “atributet e së vërtetës janë në mënyrë të mahnitshme të dukshme gjatë gjithë historive të ungjillit”.³⁴ Rregulli i parë i Greenleaf për kritikizmin dokumentar ishte ky: “Çdo dokument, në dukje i lashtë, që vjen nga burim informacioni ose mbikëqyrje e duhur dhe që nuk mban në fytyrën e vet asnjë shenjë të dukshme falsiteti, ligji e supozon si të vërtetë dhe i kalon anës kundërshtuese barrën që të vërtetojë se është ndryshe”.³⁵ Kjo gjë e kthen topin mbrapsht në fushën e kritikut.

Së katërti, 200 vjet sulmesh të vendosura duket se nuk e kanë dëmtuar Biblën. Në fund të vitit 1974 revista “*TIME*” kishte një artikull të titulluar: “Sa e vërtetë është Bibla?” dhe arrinte në këtë përfundim: “Gjerësia, sofistikimi dhe diversiteti i gjithë këtij hetimi biblik është mbresëlënës, por lypet të bëhet një pyetje: A e ka bërë kjo Biblën më shumë apo më pak të besueshme? ... Pas më shumë se dy shekujsh përballimi me armët më të rënda shkencore që mund të duroheshin, Bibla ka mbijetuar — dhe ndoshta këto sulme e kanë bërë atë të shfaqet më mirë. *Madje edhe po të flasim me termat e vetë kritikëve — pra, me faktet historike — Shkrimet duken më të pranueshme tani, sesa kur racionalistët filluan sulmin*”.³⁶

Së pesti, ai që është i përgatitur për të hequr të gjithë këtë mënjanë dhe të ndryshojë integritetin dhe autoritetin e Biblës mund të bëjë pyetjet e mëposhtme: “A është kundërshtimi im ndaj Biblës i nxitur nga paragjykimi dhe parimi? A kam njohuri të thella për tri gjuhët (hebraisht, greqisht dhe aramisht) në të cilat Bibla u shkrua në fillim? A e kam kuptuar kontekstin në të cilin është hartuar secili libër? A kam kuptuar si duhet çdo pasazh dhe sensin në të cilin shkrimtari përdori fjalët dhe numrat? A mundem unë që në çdo rast të identifikoj përdorimin e gjuhës së autorit, që të vendos nëse ai përdorte metaforë ose hiperbolë, apo përdorte krahasim a idiomë të atij vendi? A jam i sigurt nëse çdo pasazh i dhënë është alegori, shëmbëlltyrë apo një tregim i vërtetë? A e kuptoj domethënien e secilit prej ligjeve fetare apo civile dhe zakoneve të të gjitha kohërave dhe vendeve të mbuluara nga shkrimtarët e Biblës? A jam i sigurt se asnjë

studim tekstual ose arkeologjik nuk do të hedhë më shumë dritë mbi çështjet në fjalë? A jam singerisht i hapur për të qenë i bindur se Bibla është vërtet Fjala e Perëndisë dhe se ajo më flet mua?” Çdo individ që mund t’u përgjigjet vërtet “Po” gjithë këtyre pyetjeve, ose kush ndien se ka ndonjë autoritet tjetër të besueshëm ku të mbështesë mospranimin e Biblës, mund të ndihet i kualifikuar të vazhdojë me sulmin e tij. Nëse jo, me siguri që do të jetë diçka më e mençur dhe më e përlurur të provojë një mënyrë tjetër.

Mbrojtja

Kur predikuesit britanik të shek. XIX Charles Spurgeon iu kërkuar të mbronin Biblën, ai u përgjigj: “Të mbrojt Biblën? Më mirë të mbroja një luan! Lëshojeni!” Këto ishin fjalë që e karakterizonin Spurgeon, por “mbrojtje” është një fjalë përsosmërisht e mirë për të përshkruar se çfarë gjejmë kur hapim Biblën dhe e lëmë atë të flasë për veten.

Së bashku

Ashtu siç e pamë më parë, Bibla nuk është një libër i vetëm, por një “bibliotekë” prej gjashtëdhjetë e gjashtë dokumentesh të shkruara nga dyzet autorë në intervalë që shtrihen mbi më shumë se 1,500 vjet. Ata përfshinin një mbret, një burrë shteti, një guvernator, një shërbëtor civil, një doktor dhe të paktën dy peshkatarë, po ashtu një çadërbërës dhe disa për të cilët nuk dimë asgjë veç emrave të tyre. Ata jetuan në kohëra dhe vende të ndryshme dhe pak prej tyre u takuan me njëri-tjetrin. Mund të supozojmë se po të pyeteshin për ndonjë temë të nxehtë, përveç fesë, ata do të kishin aq mendime të ndryshme, sa mund të presim të dëgjojmë në ndonjë shfaqje debati në media. Megjithatë, pa ndonjë bashkëpunim ose manipulim opinionit, ata na kanë dhënë një trup shkrimi që në mënyrë të mahnitshme ka lidhje logjike.

Duke komentuar mbi këtë, teologu britanik J. I. Packer thotë: “(Bibla ka) një lidhje logjike organike që thjesht të befason. Libra të shkruar shekuj veç njëri-tjetrit duket se ishin skicuar për të shprehur qëllimin e plotësisht

dhe ndriçimit të njëri-tjetrit ... Vërtet, uniteti i brendshëm i Biblës është i mrekullueshëm: një shenjë dhe habi që sfidon mosbesimin e epokës sonë skeptike”.³⁷ Kjo vështirë se mund të jetë provë se shkrimtarët të gjithë thoshnin të vërtetën, megjithatë, ndërsa e vërteta bashkon dhe gabimi ndan, si mundet që çdo gjë që shkruan të përzihet kaq përsosmërisht së bashku? Uniteti i Biblës është kaq i mahnitshëm, saqë ndonjëri mund të falet nëse mendon se gjithë shkrimtarët e saj flisnin me një zë — apo pikërisht këtu qëndron e gjithë çështja? ...

Zëri i Zotërisë së tyre

Nëse e “lëshojmë” ashtu siç rekomandoi Spurgeon, mesazhi i vetëm e i fuqishëm që vjen qartë përmes saj është pohimi i Biblës se *nuk është asgjë më pak se Fjala e Perëndisë*. Në Dhiatën e Vjetër 17 nga 39 librat e saj janë kryesisht profeci dhe 17 histori, ndërsa pesë të tjerët që mbeten janë poezi. Profetët nuk ngurruan në pohimin se, kur flisnin në mënyrën profetike, ata vepronin si zëdhënës të Perëndisë dhe se mesazhi i tyre duhej të trajtohej sikur vinte drejtpërdrejt prej tij — prandaj i njëjti pretendim përshkon gjithë librat e tjerë. Shprehje si: “Perëndia tha”, “Perëndia foli” dhe “Fjala e Zotit erdhi” shfaqen diku te 700 herë vetëm në pesë librat e parë (historikë) dhe diku te 40 herë në një kapitull. Në Dhiatën e Vjetër e marrë në tërësi ka rreth 4,000 pohime të drejtpërdrejta për autorësi hyjnore. Asnjë letërsi tjetër që njeh njeriu nuk bën pohime kaq të qarta dogmatike dhe të qëndrueshme.

Ne shohim të njëjtën gjë në Dhiatën e Re. Apostulli Pal, i cili shkroi të paktën trembëdhjetë nga 27 librat e saj, jo vetëm që e përshkruante Dhiatën e Vjetër si “fjalët e vërteta të Perëndisë”,³⁸ por nuk ngurroi për autoritetin e shkrimeve të tij: “Nëse ndonjëri mendon se është profet ose frymëror, le të njohë se ato që po ju shkruaj janë urdhërime të Zotit”.³⁹ Në një vend tjetër ai i lavdëroi ata që morën mesazhin e tij “jo si fjalë njerëzish, por sikurse është me të vërtetë, si fjalë Perëndie”,⁴⁰ duke këmbëngulur se ishte goja e Perëndisë që kishte përgjegjësi jo për ta hartuar mesazhin, por për ta dorëzuar atë.

Kontribues të tjerë të Dhiatës së Re thanë të njëjtën gjë. Apostulli Pjetër nuk ngurroi të thoshte se shkrimi i tij vinte “nga qielli”.⁴¹ Apostulli Gjon, një autor tjetër i rëndësishëm i Dhiatës së Re, e filloi librin e fundit në Bibël duke thënë se ajo për të cilën do të shkruante ishte “Fjala e

Perëndisë”⁴² dhe e mbylli duke i siguruar lexuesit se fjalët e tij ishin “të besueshme dhe të vërteta”, që kishin ardhur tek ai drejtpërdrejt nga “Zoti, Perëndia i frymëve të profetëve”.⁴³

Pohimi më saktë i Biblës për autoritetin e vet hyjnor është: “I gjithë shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia”.⁴⁴ “I frymëzuar nga Perëndia” është përkthimi i mbiemrit në greqishten origjinale, “*theopneustos*”, nga emri “*theos*” (Perëndi) dhe folja “*pneo*” (të marrësh frymë). Kjo nuk na tregon se shkrimtarët ishin të frymëzuar, por ajo që ata shkruan kishte dalë (ishte frymënxjerrë) nga Perëndia — se Perëndia “frymënxori” po ato fjalë që ata shkruan. Ashtu si vetëshprehet Pjetri kur iu referohet shkrimeve të Dhiatës së Vjetër: “Prefecia nuk erdhi asnjëherë nga vullneti i njeriut, por njerëzit folën prej Perëndisë ndërsa ishin rrëmbyer nga Fryma e Shenjtë”.⁴⁵

Në këtë pikë kritikët kërcejnë shpejt duke thënë: “Të thuash se Bibla është Fjala e Perëndisë për shkak se ajo thotë se është Fjala e Perëndisë është sikur të argumentosh në rrathë”. Kjo mund të tingëllojë sikur e vulos argumentin, por në përgjigje të kësaj mund të thuhet katër gjëra.

Së pari, ne të gjithë e njohim idenë e të *apeluarit në autoritete më të larta*. Në Angli krimi i rëndë gjykohet në gjykatën e Kurorës dhe një person i dënuar atje mund të apelojë në bazë të një pike të ligjit në Divizionin Kriminal të Gjykatës së Apelit. Nëse ky apel dështon, atëherë mund të çohet në Dhomën e Lordëve. Kjo është gjykata e fundit e apelit në Angli, por çështja mund të shtyhet një hap më tej, në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Por aty është fundi i rrugës, sepse ligji anglez nuk njeh autoritet më të lartë. Në filozofi dhe në fe ndodh e njëjta gjë.

Së dyti, të gjitha pretendimet për autoritet absolut kanë në vetvete autoritet të tillë ose përndryshe nuk mund të mbështeteshin. Për shembull, ata që besojnë se arsyeja njerëzore është autoriteti përfundimtar duhet ta shohin arsyen njerëzore si bazë kur pohojnë se është ashtu. Ky është arsyetim rrethor — por si mund të shmanget? E njëjta gjë është e vërtetë për ata që pohojnë se logjika ose shkenca ka autoritet absolut; vetëm duke paramenduar atë që ata po thonë mund të bëhet pohimi i tyre. (Të vetmit njerëz që e shmangin këtë janë skeptikët e vijës së fortë, por ata përfundojnë në konfuzion të pashpresë, sepse, nëse janë absolutisht të qëndrueshëm, duhet të jenë skeptikë për vetë skepticizmin për të cilin këmbëngulin!)

Së treti, tashmë kemi parë se *Bibla nuk është libër i zakonshëm*. I provuar

në çfarëdo mënyre të mundshme, integriteti i saj mbetet i paprekur, me dëshmitarë si historia, gjeografia dhe profecia, të cilat sigurojnë dëshmi mbështetëse mbresëlënëse. Kjo dëshmi është kaq solide, saqë, të paktën, është e arsyeshme të supozosh se Bibla mund të besohet, gjithashtu, kur flet me mijëra herë për origjinën e vet. Bibla është libri i vetëm që njohim se pohon nga faqja në faqe se është mesazhi i drejtpërdrejtë me fjalë i Perëndisë, prandaj teologu amerikan John Frame nuk e tepron kur thotë: “Nëse ligjërata e Perëndisë ka një vend të dukshëm, ky vend duhet të jetë në Shkrimet e Shenjta. Nuk ka asnjë kandidat tjetër”.⁴⁶ Me regjistrimin e saj të përsosur nuk është e arsyeshme dhe logjike ta akuzosh atë se ka bërë me mijëra pohime të rreme dhe blasfemuese rreth autorësisë së saj — dhe ta bësh këtë pa ndonjë dëshmi që ta mbështesë akuzën. Të përpiqesh të shmangësh pohimin qendror të Biblës është si të përpiqesh të shmangësh një ortek duke e qëlluar me një gur. Bibla na jep shumë arsye mbresëlënëse që të besojmë se është tamam ajo që pohon se është — “fjala e gjallë dhe e përjetshme e Perëndisë”.⁴⁷

Së katërti, nëse Perëndia krijoi gjithë realitetin jashtë vetes së tij dhe ka autoritet sovran mbi gjithë krijimin, si mund t’i drejtohet një autoriteti më të lartë që të vërtetojë ekzistencën, atributet dhe qëllimet e veta? Bibla e sqaron këtë kur dëshmon se si Perëndia vendosi një besëlidhje me patriarkun e Dhiatës së Vjetër, Abrahamin: “Duke qenë se s’kishte asnjë më të madh që të përbetohej, bëri be me veten e tij”.⁴⁸ Ashtu si teologu i shekullit të katërt, Hilary i Poitiers, komentoi: “Vetëm Perëndia është një dëshmitar i përshtatshëm për veten e vet”.⁴⁹ Për të njëjtën arsye, nëse Bibla është Fjala e Perëndisë, si mund të na drejtojë ajo në një autoritet më të lartë, në mënyrë që të vërtetojë pohimet e saj?

Disa njerëz përpiqen të gjejnë një rrugë të mesme duke thënë se, megjithëse Bibla nuk është Fjala e Perëndisë, është një libër shumë i moralshëm, që ka shumë për të na mësuar, por kjo ide asnjëherë nuk ka sukses. Po të mos ishte Bibla Fjala e Perëndisë, megjithatë ajo pohon se është, do të ishte libri më i rrezikshëm, blasfemues dhe i urryer që është shkruar ndonjëherë, që na gënjen për origjinën tonë, që na jep një bazë të rreme për dinjitetin njerëzor, që e bën të rreme një kornizë për kuptimin dhe qëllimin e jetës dhe që na mashtron mizorisht rreth asaj që shtrihet përtej varrit. Ta quash Biblën një libër të mirë, por jo “Librin e Perëndisë”, është një pohim të cilit i mungon, madje, logjika bazë.

Verdikti i Zotërisë

Ashtu si do ta shohim edhe më vonë, mesazhi i Biblës, përfundimisht, ka në qendër personin dhe veprën e Jezusit nga Nazareti. Kjo të habit shumë, sepse studiues të kujdesshëm kanë vënë në pah se “Shkrimi i vesh Jezusit çdo emër, çdo atribut dhe çdo titull kryesor të Perëndisë”.⁵⁰ Nëse Jezusi foli me autoritet hyjnor, vlerësimi i tij për Biblën do të ishte mbështetja më e mirë e mundshme për pohimet e tij — prandaj nuk na ka lënë të hamendësojmë se cili ishte vlerësimi i tij. “Bibla” e vetme që Jezusi kishte në kohën e tij ishte Dhiata e Vjetër, por ai është regjistruar duke cituar fjalë për fjalë prej saj afërsisht dyzet herë (nga trembëdhjetë libra të ndryshëm) gjatë kohës që ai mësonte të tjerët dhe se i referohet asaj në shumë raste të tjera. Si e vlerësonte ai atë?

Së pari, ai pranonte pa vënë në dyshim se historia e saj ishte e besueshme. Ai përdori të paktën pesëmbëdhjetë ngjarje të regjistruara në Dhiatën e Vjetër për të ilustruar të vërteta frymërore për çështje si martesë, marrëdhëniet familjare, mrekullitë, gjykimin përfundimtar, parajsën dhe ferrin.

Së dyti, ishte i vetmi trup mësimi për të cilin ai dha miratimin e tij dhe pranoi autoritetin e saj të pandryshueshëm në çdo temë së cilës i drejtohej duke u thënë dëgjuesve të tij: “Shkrimi nuk mund të shkelet”.⁵¹

Së treti, ai ishte aq shumë i shqetësuar që ajo të kuptohej si duhej, saqë shpesh i korrigjonte ata që e keqinterpretonin ose abuzonin me të.

Së katërti, ai pohonte se e gjithë Dhiata e Vjetër ishte një prelud profetik për ardhjen e tij në botë; sa për të dhënë një shembull, ai vuri në dukje tri ndarjet kryesore të Dhiatës së Vjetër dhe tha: “Se duhet të përmbushen të gjitha gjërat që janë shkruar lidhur me mua në ligjin e Moisiut, në profetët dhe në psalmet”.⁵² Jezusi e shihte veten si çelësi për të kuptuar çdo gjë që thoshte Dhiata e Vjetër.

Së pesti (dhe pika e vetme që duhet të theksojmë këtu), ai e bënte të qartë se e pranonte të tërë Dhiatën e Vjetër si të ishte Fjala e Perëndisë. Duke sfiduar ata që e vinin në dyshim jetën pas varrit, ai i pyeti: “A nuk e keni lexuar atë që Perëndia ju tha ...?” dhe pastaj citoi fjalët e folura nga Moisiu.⁵³ Duke sulmuar hipokritët që ishin duke interpretuar keq pohimet në dy librat e Dhiatës së Vjetër, ai i akuzoi “që kishin hequr mënjanë urdhërimet e Perëndisë”.⁵⁴ Duke cituar një prej psalmeve, ai tha se Davidi (autori njerëzor) po “fliste nga Fryma e Shenjtë”.⁵⁵ Për aq sa i përket Jezusit, atë që tha Bibla e tha edhe Perëndia.

E ardhmja — tani!

Mbështetja tjetër e pohimit të Biblës se është Fjala e Perëndisë ngre një temë që mahnit me miliona njerëz — parashikimi i së ardhmes. Në maj të vitit 1997 një titull në faqen e parë të gazetës “*Daily Mail*” bëri njoftimin që binte në sy se analizat kompjuterike të bëra Biblës kishin zbuluar një kod të fshehtë “që parashikon çdo ngjarje në histori”.⁵⁶ Faqet e brendshme të gazetës e zbutnin këtë pohim duke shkruar: “çdo ngjarje kryesore në histori”, e megjithatë përsëri ishte një pohim mahnitës dhe bëri mrekullira për shifrat e qarkullimit të gazetës. Më vonë, gazetari Michael Drosnin i mbledhi gjithë materialet dhe në “*Kodi i Biblës*” pohonte se zbritja e parë e njeriut në hënë më 1969, skandali i Watergate më 1974 që e detyroi presidentin e Shteteve të Bashkuara të largohej nga posti, përplasja e kometës Shoemaker-Levi me Jupiterin më 1994 dhe vrasja e kryeministrit të Izraelit Yitzhak Rabin më 1995 ishin të koduara në pasazhet e Biblës e shkruajtur 3,000 vjet më parë.

Fama e Drosnin ra shpejt, sidomos kur u gjend se dikush mund të “parashikojë” ngjarje të tjera të mëdha duke zbatuar të njëjtin program kompjuterik në libra si “*Lufta dhe Paqja*” dhe “*Mobi Dik*”! — por kjo nuk ndodhi para se “*Kodi i Biblës*” të bëhej libri më i shitur për pak kohë.

Fizikanti francez i shekullit XVI Michel de Nostradame, i njohur në përgjithësi si Nostradamus, shkroi 942 poema me nga katër vargje, ku thuhej se parashikonin ngjarjet e së ardhmes. Ai kishte një interes të madh në astrologji, qartëpamje dhe okult, e poemat e tij, të shkruara në një përzierje ngatërruese prej pesë gjuhësh, janë shprehur në terma kaq të mjegullta, saqë mund t’i përshtaten çdo gjëje, nga falimentimi i tregut të aksioneve deri te një shpërthim tërmetesh, e megjithatë një numër i madh njerëzish ende kërkojnë tek ai të dhëna dhe ai ka afërsisht 850 faqe në kërkuesin tim të preferuar të faqes së internetit. Libri i përvitshëm “*Almanaku i Moor-it*” (Moor’s Almanack), botuar për herë të parë më 1680 si “*Vox Stellarum*” (Zëri i yjeve), ende ka shumë lexues kudo në botë, megjithatë një studim i kujdesshëm i parashikimeve të 200 astrologëve të profilit të lartë në një vëllim të zgjedhur në mënyrë të rastësishme, treguan se më pak se pesë për qind u materializuan dhe se këto mund të ishin mbështetur në probabilitet, brenda njohurisë ose spekulimit të mprehtë.

Pavarësisht nga këto fakte, oreksi njerëzor për të ditur se çfarë shtrihet

përpara duket i pangopur. Miliona njerëz lexojnë horoskopet të botuara në revista dhe gazeta të panumërta, ndërsa të tjerë kërkojnë të dhëna në topa kristali, gjethe çaji ose letrat tarot. Megjithatë, është mëse e sigurt të thuash se vështirë se ndonjëri që bën këto gjëra kupton dy gjëra të shënuara rreth Biblës — së pari, se rreth tridhjetë për qind e saj përbëhet nga profeci të një lloji ose një tjetër; dhe, së dyti, se *asnjë profeci e vetme e bërë sipas kriterëve të veta nuk ka dalë e rreme*. Me siguri që kjo duhet të kapë vëmendjen tonë.

Edhe pse profecia e vërtetë e Biblës ndonjëherë ka të bëjë me shëndetin, nevojat e përditshme dhe çështjet familjare të individëve, ajo asnjëherë nuk katandiset në marrëzinë e parëndësishme të tregtuar nga maniakët, sharlatanët dhe artistët e remë, e cila synon, kryesisht, t'i bëjë masazh faktorit të të ndjerit mirë të njerëzve. Pjesa më e madhe e profecive në Shkrim përfshin çështje të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe bën parashikime dogmatike të ngjarjeve në të ardhmen, ndonjëherë duke qenë shumë specifike rreth kohës kur do të ndodhin, në mënyrë që saktësia e tyre të mund të kontrollohet. Kjo vështirë se mund të na habisë, nëse profetët ishin zëdhënësit e Perëndisë dhe po pasonin informacionin që ai u kishte dhënë atyre, por kjo ngrinte një problem të dukshëm: si do ta dinin njerëzit nëse ata që pretendonin se ishin profetë ishin të vërtetë dhe se fjalët e tyre mund të besoheshin? Ja, cila ishte prova: “Nëse ajo që profeti pohon në emër të ZOTIT nuk ndodh ose nuk realizohet, ai mesazh nuk është folur nga ZOTI. Profeti ka folur me mendjemadhësi. Mos kini frikë nga ai”.⁵⁷

Kjo është shumë e ndryshme nga të thënit se, nëse ndonjë profeci e dhënë dilte të ishte e drejtë, atëherë personi që e kishte bërë atë ishte një profet i vërtetë. Çdokush mund të bëjë një parashikim të drejtë herë pas here (ashtu siç bëjnë ata që vënë baste për ndeshjet e futbollit apo garat me kuaj sot), megjithatë kjo nuk ishte provë e besueshmërisë së tij. Përkundrazi, *nëse edhe një profeci zbulohet se ishte e rreme, pretendimi i profetit se ishte e vërtetë nuk do të kishte ku të mbahej*. Thirrja e tij se ishte “vetëm njeri”, “i prirë për të marrë gabim gjërat herë pas here”, nuk ishte e mirë. Një profet i vërtetë *gjithmonë* e merrte profecinë si duhej, edhe atëherë kur ajo dukej qesharake. Skeptikët ndonjëherë sugjerojnë se “profecitë” bëheshin pas ngjarjeve që ato parashikonin, por ka shumë raste në të cilat datimi i tyre e përjashton këtë mundësi, prandaj ky sulm nuk ka kuptim.

Por a nuk kishte ndonjë mundësi, pavarësisht se mund të ishte shumë e largët, se njerëzit që pretendonin të ishin profetët e Perëndisë nuk ishin asgjë më shumë se fanatikë fetarë të cilëve “thjesht u ndodhi ta merrnin si duhet”? Peter Stoner, profesor Emeritus në Kolegjin Westmont, në Kaliforni, dhe anëtar nderi i Shoqatës Shkencore Amerikane, i përgjigjet pyetjes duke u përqendruar në vetëm njëmbëdhjetë profeci të marra nga shkrimet e katër profetëve, Isaia, Jeremia, Ezekieli dhe Mikea. Këto profeci lidheshin me tokën në tërësi, shkatërrimin e Jeruzalemit, rindërtimin e tempullit të tij dhe zmadhimin e mëvonshëm të qytetit — dhe ato u përmbushën të gjitha, gjërmë për gjërmë. Duke llogaritur probabilitetin e kësaj që mund të ndodhte rastësisht një herë në 8x10 në fuqi 63, Stoner ilustron se çfarë do të thotë kjo. Ai thotë se po të mblidhnim bashkë një pirg monedhash të barabarta në masë me 100 miliardë yje në secilën prej dy trilion galaksive vetëm në një sekondë, t’i shtojmë pirgut në të njëjtën shpejtësi çdo sekondë, ditë dhe natë për njëzet e një vjet, pastaj t’i kërkojmë një shoku me sy të mbyllur të tërheqë një monedhë nga ky pirg aq masiv, sa nuk mund ta kuptojmë dot, mundësitë e tij për ta bërë këtë do të ishin të njëjta me ngjashmërinë se këta katër profetë mund t’i kishin marrë parashikimet e tyre pikërisht përmes hamendësimit.⁵⁸

Kjo të bën mjaft përshtypje, e megjithatë këto janë vetëm njëmbëdhjetë profeci nga disa qindra të regjistruara vetëm në Dhiatën e Vjetër. Cilat mund të jenë gjasat kundër *gjithë* atyre si të ishin hamendësime? Duke shkruar për dëshminë për të cilën ai e quan “Gjurmët e gishtave të Perëndisë në Bibël”, autori britanik John Benton thotë kuptueshëm se mësimi i saj profetik ka “të ngjarë të jetë dëshmia më e drejtpërdrejtë për përfshirjen e veçantë të Perëndisë me këtë libër”.⁵⁹

Revolucione

Një arsye e katërt për ta besuar Biblën është rekordi i saj unik në ndryshimin për më mirë të jetëve të individëve dhe shoqërive të tëra. Në kohën e Dhiatës së Re kisha e krishterë në Korint përfshiu në anëtarësinë e saj ata që kishin qenë imoralë, idhujtarë, shkelës kurore, porstituta meshkuj, homoseksualë, hajdutë, lakmitarë, pijanecë, shpifës dhe batakçinj, e megjithatë të gjithë ishin transformuar nga e vërteta biblike.⁶⁰ Që atëherë, miliona të tjerë i kanë shtuar dëshmisë së tyre se ndikimi i Biblës kishte revolucionarizuar për mirë cilësitë morale të jetëve të tyre.

Në një shkallë më të gjerë, asnjë grup i identifikueshëm i qenieve njerëzore nuk ka një ndikim më pozitiv në kulturën e tyre bashkëkohore, sesa ata që kanë qenë të motivuar dhe drejtuar nga Bibla. Ata kanë themeluar shkolla, spitale dhe institucione bamirësie të panumërta dhe, ashtu siç e thotë edhe autori i shquar britanik John Stott, ndikimi i tyre ka qenë jashtëzakonisht përfitues në shumë fusha të tjera: “Ata ndaluan tregtinë e skllëvërve dhe liruan skllëvërit, përmirësuan kushtet e punëtorëve në mullinj dhe miniera, si dhe të të burgosurve në burgje. Ata mbronin fëmijët nga shfrytëzimi tregtar në fabrikat e Perëndimit dhe nga prostitucioni ritual në tempujt e Lindjes. Sot ata u sjellin të sëmurëve me lebër jo vetëm dhembshurinë e Jezusit, por edhe metodat moderne të kirurgjisë rindërtuese dhe rehabilitimit. Ata kujdesen për të verbrin dhe të shurdhrin, jetimin dhe të venë, të sëmurët dhe ata që vdesin. Ata gjenden pranë narkomanëve dhe rrinë me ta gjatë periudhave traumatizuese të kohës së tërheqjes prej drogave. Ata janë kundër racizmit dhe shtypjes politike. Ata përfshihen në skenën urbane, në qytetet e brendshme, në lagjet e pista dhe getot, si dhe protestojnë kundër kushteve çnjerëzore në të cilat shumë njerëz janë shtyrë të jetojnë. Ata kërkojnë në çfarëdo mënyre që munden të shprehin solidaritetin e tyre me të varfrit dhe të uriturit, të privuarit dhe ata që nuk kanë avantazhe”.⁶¹

Askush nuk po sugjeron se vetëm besimtarët e Biblës janë përfshirë në punë të tillë, por rekordit të tyre nuk ia kalon asnjë. Është llogaritur se 75% e revolucionit shoqëror që përfshiu shoqërinë perëndimore në shekujt e tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë u shty nga mësimi biblik, me emra të tillë si William Wilberforce (ndalimi i skllavërisë), Elisabeth Fry (reforma e burgjeve), Earl i shtatë i Shaftesbury (përmirësimi i statusit dhe kushteve të të sëmurëve mendorë) dhe Thomas Bernardo (strehimi i fëmijëve të varfër) mes atyre që kishin pjesë në udhëheqje. Sot, vende ku liria, drejtësia dhe toleranca janë normë, janë pothuajse të gjithë të ndikuar nga mësimi i Biblës, në kontrast të mirëfilltë me ata që e kanë hedhur qëllimisht poshtë atë. “*Libri i Njohurisë*” nuk e ekzagjeron rastin kur thotë: “E konsideruar thjesht si letërsi, *përveç asocimeve fetare të saj*, Bibla, në çdo gjuhë, ka bërë përshtypje të madhe te mendja njerëzore më shumë sesa çdo libër tjetër në botë, prandaj nuk mund të vlerësohet se deri ku ajo i ka dhënë formë ideve të botës dhe kështu historisë së botës”.⁶² Sigurisht që ka pasur raste (Kryqëzatat famëkeqe dhe Inkuizicioni në epokën e errët dhe në epokën e mesme janë shembuj

të tmerrshëm) në të cilat udhëheqësit fetarë kanë keqzbatuar mësimin e Biblës për të justifikuar dhunën e papërshtueshme, por këto janë përjashtime që vërtetojnë rregullin dhe ndikimi i pashoq i Biblës për mirë është jashtëzakonisht mbresëlënës.

Marrja e mesazhit

R. C. Sproul ka shkruar: “Nëse Bibla është e besueshme, atëherë duhet ta marrim seriozisht pohimin se ajo është më shumë se e besueshme”⁶³ prandaj vetëm këto pak faqe kanë dhënë arsye të mjaftueshme për të besuar se Bibla është Fjala e Perëndisë. Megjithatë, ky është vetëm hapi i parë për t’u përgjigjur asaj si duhet. Nuk na është dhënë vetëm për informacion, por për transformimin tonë, në mënyrë që, ndërsa mesazhi i saj mbërthen mendjet dhe ndryshon zemrat tona, mund të kemi një pikëpamje për botën dhe një mënyrë jete me Perëndinë në qendër.

Po cili është mesazhi i saj?

Gjëja e parë për t’u kuptuar është që Bibla nuk është një koleksion i parregullt pohimesh — as edhe i pohimeve të vërteta dhe të vlefshme. Çdo vit Gideons International vendosin miliona Bibla në vende si hotele, spitale, shkolla, kolegje, universitete e burgje, dhe këto Bibla përfshijnë udhëzime që tregojnë se ku të shkojnë për ndihmë në kohë nevojë të veçantë. Këto udhëzime janë zgjedhur në mënyrë të kujdesshme dhe të ndjeshme, prandaj shumë njerëz kanë gjetur ndihmë jetëndryshuese kur kanë ndjekur këshillën e tyre, por kjo nuk është mënyra më e mirë për të “marrë mesazhin”. Bibla nuk është versioni frymor i një libri vjetor të tregtisë, as nuk duhet ta trajtojmë si “lojë fati”, duke vënë gishtin në një faqe dhe të përpiqemi të bëjmë çfarë thotë aty. Mbi të gjitha, mund të shfaqen tri goditje vdekjeprurëse: “kështu Juda ... u largua dhe vari veten”,⁶⁴ “Shko dhe bëj edhe ti ashtu”⁶⁵ dhe “Atë që ke ndërmend të bësh, bëje shpejt”.⁶⁶ Të trija pohimet janë marrë drejt nga Bibla, por t’i shkëputësh ato nga konteksti dhe t’u bindesh atyre fjalë për fjalë vështirë se do ta bënin jetën më të vlefshme.

Afrimi biblik është të fillosh duke kuptuar se është një mesazh për Perëndinë dhe njeriun, si dhe për marrëdhënien e tyre me njëri-tjetrin. Po

të përdorim një shprehje shumë moderne, Bibla ka një metarrëfenjë (në gjuhën e zakonshme një vijë ngjarjesh). Kjo konfirmohet nga harmonia e saj mahnitëse. Në ilustrimin e gjallë të J. I. Packer, Bibla është si një orkestër simfonike në të cilën “çdo instrument në mënyrë të vullnetshme, spontane dhe krijuese luan notat e tij *ashtu si dëshiroi dirigjenti i madh*, edhe pse asnjë prej tyre nuk mund ta dëgjonte ndonjëherë muzikën si një e tërë”.⁶⁷ Nuk është një përzjerje e mjegullt idesh që u erdhi guruve fetarë të cilët pretendonin të kishin thellësi mistike. Përkundrazi, mesazhi i saj rrënjësohet në jetët e njerëzve të vërtetë, nga mbretërit dhe mbretëreshat te burrat e shtetit dhe shërbëtorët civilë, nga ushtarët te barinjët, nga burrat dhe baballarët te gratë dhe nënat, të gjithë të endur në baticën dhe zbaticën e ngjarjeve historike, shumë prej të cilave mund t’u gjenden gjurmët. Në hapësirën që kemi në dispozicion këtu mund të japim vetëm një ravijëzim shumë të shkurtër të asaj se çfarë është ai mesazh, duke filluar me disa nga shumë pohime që Bibla bën rreth natyrës së vetë Perëndisë.

Natyra e Perëndisë

- Perëndia është *unik*: “Nuk ka Perëndi tjetër”.⁶⁸ Gjithë “perënditë” e tjera janë trillime të imagjinatës njerëzore.
- Perëndia është *person*, jo një “gjë” si pluhuri kozmik apo energjia atmosferike. Perëndia mendon, zgjedh, premton, i mban premtimet dhe është “i dhembshur dhe i hirshëm”.⁶⁹ Është thënë se “fakti përfundimtar rreth universit është një Perëndi person”.⁷⁰ Edhe pse është vetëm një Perëndi, ai ekziston në tri persona, “Ati ... Biri ... dhe ... Fryma e Shenjtë”,⁷¹ secili prej tyre plotësisht hyjnor, i barabartë me dy të tjerët.
- Perëndia është *frymëror*, pa dimension material si një trup fizik. “Perëndia është frymë”.⁷²
- Perëndia është *përjetësisht vetekzistues*, as i krijuar dhe as i sjellë në ekzistencë nga ndonjë fuqi ose pushtet. Ai nuk rrjedh nga ndonjë dhe është i pavarur, “Perëndia i përjetshëm”,⁷³ që është “nga përjetësia në përjetësi”.⁷⁴
- Perëndia është *transhendent* gjatë kohës dhe mbi kohë, hapësirë dhe gjithçka tjetër, ai që “qiejt, madje edhe qiejt më të lartë, nuk mund ta mbajnë”.⁷⁵
- Perëndia është i *pandryshueshëm*: ai “nuk ndryshon si hije ndryshimi”.⁷⁶

- Perëndia është i *shenjtë*, tërësisht pa të meta, njollë, dobësi, mangësi apo paafësi; sipas metaforës së gjallë të Biblës: “Perëndia është dritë; në të nuk ka kurrfarë errësire”.⁷⁷
- Së fundi, sipas vetë fjalëve të Biblës: “Perëndia është dashuri”⁷⁸ dhe të gjitha veprimet e tij, madje edhe ato që duken sikur tregojnë të kundërtën për të kuptuarit tonë të kufizuar, janë shprehje e “dashurisë së tij që nuk dështon”.⁷⁹

Origjina e universit

Duke lëvizur në linjën e tregimit të Biblës, na thuhet në fjalët që e hapin atë se “në fillim Perëndia krijoi qiellin dhe tokën”.⁸⁰ Në gjuhën origjinale hebreje nuk kishte një fjalë të vetme për të përshkruar universin, prandaj shprehja “qiellin dhe tokën”, thjesht, do të thotë gjithë realiteti, përveç vetë Perëndisë, nga asteroidët te milingonat, nga koha te titaniu, nga mamothët te mikrobet, nga energjia te elefantët dhe nga forca e rëndesës te karkalecat. Për më tepër, ai nuk e krijoi universin nga ndonjë lloj substance apo esence që ekzistonte më parë, por krijoi çdo gjë nga asgjë: “Bota është ndërtuar me fjalën e Perëndisë, saqë ato që shihen nuk u bënë prej gjërave që shihen”.⁸¹ Shumë njerëz ngatërrohen me çështjen e krijimit duke u përqendruar më shumë mbi *mekanizmin* e tij sesa në *kuptimin* e tij. Fakti është që, sado të përpiqemi të manipulojmë të dhënat, Bibla nuk na thotë saktësisht se si dhe kur ndodhi krijimi. Përkundrazi, fokusi i saj është në faktin thelbësor se “Perëndia ... bëri qiellin, tokën dhe detin e çdo gjë që kanë ata”.⁸²

Krijimi i njeriut

Ndryshe nga çdo gjë në gjithë rendin krijues:

Perëndia krijoi njeriun
sipas shëmbëlltyrës së vet,
 Sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë;
 Ai krijoi mashkullin e femrën.⁸³

Fjalët që kam theksuar nxjerrin në pah faktin që njeriu është unik. Ato nuk kanë të bëjnë fare me masën, peshën, formën apo ndonjë cilësi tjetër

materiale, sepse Perëndia nuk ka asnjë nga këto, por ato shpjegojnë se përse ne si njerëz kemi personalitet që na jep pushtet mendimi, ndjenje e vullneti dhe që shkon përtej instiktit të ashpër të jetës kafshërore. Krijimi ynë “sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë” shpjegon, gjithashtu, faktin se pse kemi një aftësi për t’u lidhur me Perëndinë, ta adhurojmë atë dhe të jetojmë në bashkësi me të.

Natyra e njeriut

Kur krijimi përfundoi, “Perëndia pa gjithë atë që kishte bërë dhe ishte shumë e mirë”.⁸⁴ Fjala “gjithë” përfshinte njeriun i cili u “krijua për të qenë si Perëndia në drejtësi dhe shenjtëri të vërtetë”.⁸⁵ Megjithatë nuk ishte një robot. Atij iu dha vullneti i lirë dhe përgjegjësi morale dhe për një kohë të pacaktuar (nuk e kemi idenë për sa kohë) ai zgjodhi të jetonte në bindje të plotë ndaj Bërësit të tij, prandaj, si rezultat, gëzonte një marrëdhënie të përsosur me të dhe harmoni të plotë me gjithë pjesën tjetër të krijimit.

Dikur në histori (përsëri nuk e dimë se kur) njeriu zgjodhi për herë të parë të mos i bindej Perëndisë dhe të ndiqte rrugën e tij, dhe në atë çast katastrofik “... mëkati hyri në botë përmes një njeriu, si pasojë edhe vdekja përmes mëkatis”.⁸⁶ Asnjë fjalë nuk mund të shprehë faktin e tmerrshëm dhe katastrofik. Marrëdhënia e prindërve tanë të parë me Perëndinë u copëtua; ata humbën pafajshmërinë dhe vullnetin e tyre të lirë; natyra e tyre u infektua me ide, qëndrime dhe dashuri të paperëndishme; ata e dinin se ç’do të thoshte të ndihesh fajtor, i huaj, i turpëruar, në ankth dhe i frikësuar; marrëdhëniet e tyre ndërpersonale u helmuan nga dyshimi, pandershmëria e mosbesimi dhe trupat e tyre u bënë pre e kalbjes, sëmundjeve dhe vdekjes.

Rebelimi i njeriut kundër Bërësit të vet kishte ndikim edhe më të gjerë. Hyrja e mëkatis të nxori gjithë kozmosin e krijuar nga sinkronizmi. Ligji i Dytë i Termodinamikës, që thotë se universi po çorganizohet gjithnjë e më shumë, mbështet pohimin e Biblës se tani është “afër kalbjes”.⁸⁷ Shkatërrimet natyrore, si: tërmetet, stuhitë dhe përmytjet, të panjohura para se mëkati të hynte në botë, tani janë shenja të pranisë dhe ndikimit të mëkatis.

Si pjesë e racës njerëzore, ne të gjithë trashëgojmë prishjen e prindërve tanë të parë, natyrën mëkatore, me rezultatin se edhe më të mirët prej nesh nga natyra janë me të drejtë të ekspozuar ndaj zemërimit të drejtë të një Perëndie të shenjtë.

Për shumë njerëz kjo është pika në të cilën ata braktisin ndonjë ide se Bibla mund të jetë duke treguar të vërtetën. Njerëz që kuptojnë më shumë do të pranojnë se nuk janë të përsosur dhe pranojnë verdiktin e Biblës se “të gjithë kanë mëkatur dhe kanë rënë nga lavdia e Perëndisë”.⁸⁸ Pika ku ngecin njerëzit vjen kur Bibla këmbëngul se ne mëkatojmë, sepse jemi mëkatarë, se gjëra, si: “mendime të mbrapshta, kurvëria, vjedhja, vrasja, tradhtia bashkëshortore, lakmia, keqdashja, mashtrimi, gjërat e neveritshme, zilia, shpifja, arroganca dhe marrëzia” vijnë “nga brenda, nga zemrat e njerëzve”.⁸⁹

Megjithatë, Bibla jep mësim shumë të qartë për atë që quhet ndonjëherë “mëkati origjinal”. Mbreti David i Izraelit, një nga njerëzit më të rëndësishëm në Dhiatën e Vjetër, foli sinqerisht për natyrën e tij mëkatore: “Sigurisht që isha mëkatar që kur linda, mëkatar që nga koha në cilën nëna ime më ngjizi”.⁹⁰ Apostulli Pal është një figurë e lartë e Dhiatës së Re, e megjithatë e lidh veten e vet me lexuesit e tij dhe rrëfen se të gjithë ishin “nën zemërimin e Perëndisë nga natyra, si gjithë të tjerët”.⁹¹

Njeriu nuk është një krijesë e përmirësuar moralisht, por i shkatërruar, dhe asnjë manipulim i tekstit biblik nuk mund ta bëjë atë të shprehet ndryshe. Kur vizitova anijen e famshme “*Queen Mary*”, të ankoruar në Long Beach, në Kaliforni, vura re se pasqyrat në kabinat e luksit kishin një ngjyrim si në të kuq, kështu që kur lundronin në mot të keq dhe nuk ndiheshin mirë, pasagjerët, duke u parë në pasqyra, do të mendonin se kishin një shkëlqim të shëndetshëm në fytyrat e tyre. Po një mashtrim i tillë nuk është i mundur me Biblën, e cila e tregon mëkatin në ngjyrat e tij të vërteta. Ajo e përshkruan atë si një njollë, rebelim, helm, shtrembërim, errësirë, verbëri, skllavëri, borxh, grabitje dhe mallkim, madje shton se, nëse mohojmë shturjen tonë, “mashtrojmë veten dhe e vërteta nuk është në ne”.⁹²

Për të pakësuar natyrën dhe rëndësën e mëkatit jo vetëm që është diçka e marrë, por edhe fatale, sepse ajo heq shpresat se mund të shërohem. Të vuash nga një sëmundje e pashërueshme është e rëndë, por të mos e dish se ajo është e pashërueshme, apo ta mohosh atë, e bën situatën edhe më keq. Personi që nuk e kupton ose pranon se ai ose ajo ka lindur me një sëmundje frymërore për të cilën nuk ka ilaç të shpikur nga njerëzit, është në një gjendje me të vërtetë dëshpëruese. Ashtu si shprehet edhe Bibla ironikisht: “Nuk janë të shëndetshmit ata që kanë nevojë për doktor, por të sëmurët”.⁹³

Dënimi

Rebelimi ynë i qëllimshëm kundër Perëndisë dhe ligjit të tij na ka bërë të shfaqemi ndaj zemërimit dhe gjykimit të tij të drejtë si në këtë botë dhe në atë që do të vijë. Bibla na paralajmëron: “Ai që ndjek të keqen, shkon në vdekje”,⁹⁴ dhe në terma biblikë “vdekje” do të thotë jo vetëm vdekje fizike, ndarja e shpirtit nga trupi, por vdekje frymërore, ndarja e përjetshme e shpirtit nga Perëndia. Ne jemi “caktuar që dikur të vdesim dhe pas saj të përballemi me gjykimin”,⁹⁵ dhe, po të na lihej ne në dorë, fati ynë duhet të “ndëshkohet me shkatërrim të përjetshëm dhe të hiqet nga prania e Zotit dhe nga madhështia e fuqisë së tij”.⁹⁶ Fjala që Bibla përdor zakonisht për këtë është “ferr” dhe nuk lë dyshim për realitetin e tij të tmerrshëm. Vetë Jezusi e bëri të qartë se ata që hedhin poshtë mësimin e Biblës do të “dënohen në ferr”⁹⁷ dhe se ai është “një vend torture”⁹⁸ dhe “ndëshkimi të përjetshëm”.⁹⁹

Asnjëra nga përpjekjet tona etike, morale apo fetare do të bëjë ndonjë gjë për të shëruar sëmundjen tonë frymërore apo të largojë gjykimin e Perëndisë mbi ne. Po të mendonim që të ishim të drejtë para Perëndisë, edhe përpjekjet tona më të mëdha “janë si rroba të ndotura”.¹⁰⁰ Një makinë mund të ketë transimion automatik, kontroll shpejtësie, ajër të kondicionuar dhe ndenjësë që ngrohen, por, nëse motori shkatërrohet, ajo nuk të çon asgjëkund. Në të njëjtën mënyrë, asnjë sasi “e mirë” sociale apo fetare nuk mund të zëvendësojë faktin se zemrat tona janë “mashtuese mbi çdo gjë dhe përtej çdo ilaçi”.¹⁰¹ Po të ngeleshim në dorën tonë, ne jemi fajtorë, të humbur dhe të pazotë.

Lajmi i mirë

Ky është lajmi i mirë — lajm që askush nuk mund ta kishte shpikur — dhe që mund të përmbliidhet në një fjali: “Perëndia e deshi aq shumë botën, sa dha birin e tij të vetëm, që kushdo që beson në të të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme”.¹⁰² Në një vepër dashurie të mahnitshme Perëndia ndërhyri në shkatërrimin njerëzor. Në personin e Jezusit Perëndia Bir u bë njeri dhe, edhe pse ai vetë ishte “pa mëkat”,¹⁰³ zgjodhi të merrte mbi vete ndëshkimin me vdekje fizike dhe frymërore për mëkatarët. Në vdekjen e tij në kryq ai mori përsipër mëkatet e tyre, sikur të kishte qenë përgjegjës për to. E vetmja qenie njerëzore plotësisht

i pafajshëm në histori pranoi të vuante dënimin me vdekje të dyfishtë që gjithë njerëzit e tjerë meritonin. Jezusi plotësoi kërkesat e ligjit të Perëndisë jo vetëm duke iu bindur në çdo pjesë, por duke paguar plotësisht dënimin që ai u ngarkonte të pabindurve.

Tri ditë pasi vdiq Jezusi “u deklarua me pushtet të ishte Biri i Perëndisë me anë të ringjalljes së tij nga të vdekurit”¹⁰⁴ dhe “vdekja nuk e zotëronte më atë”.¹⁰⁵ Jezusi, Biri i përjetshëm i Perëndisë, është i gjallë sot dhe është “në gjendje të shpëtojë plotësisht ata që vijnë te Perëndia përmes tij”.¹⁰⁶ Ka më shumë dëshmi (Bibla flet për “shumë prova bindëse”)¹⁰⁷ për ringjalljen e përjetshme të Jezusit nga të vdekurit, sesa për pushtimin romak të Britanisë që kishte ndodhur rreth tetëdhjetë vite më parë. Kjo provë përfshin dëshmitë e miliona njerëzve që ai u ka transformuar jetët, që u ka dhënë sigurinë se mëkatet e tyre janë falur dhe që i ka bindur ata se pas vdekjes do ta kalojnë përjetësinë me anë të hirit të Perëndisë me të në qiell, duke iu gëzuar “një trashëgimie që nuk mund të priset, kalbet apo shuhet kurrë”.¹⁰⁸

T’i përgjigjesh mesazhit

Kjo është një përmbledhje e shkurtër e linjës së tregimit të Biblës. Topi tani është në fushën e lexuesit, prandaj më lejoni të shprehem në vetën e dytë njëjës dhe t’ju pyes se cila është përgjigjja juaj. Nëse ende hedh poshtë atë që Bibla ka për të thënë, kjo ndodh sepse e ke lexuar të gjithë me një mendje të hapur dhe ke vërtetuar (të paktën për kënaqësinë tënde) se ajo ka të meta — *apo se ajo thotë se ti ke të meta?* Ashtu siç shprehet autori britanik Robert Horn: “Nëse Bibla në të vërtetë është zëri i Perëndisë për njerëzit, siç pretendon se është, atëherë ... mendimi im për Biblën vjen i dyti pas mendimit të Biblës për mua. Në fund të fundit, ajo që ka rëndësi nuk është si e gjykoj unë Biblën, por si më gjykon mua Autori i saj”.¹⁰⁹ A mund të thuash ndershmërisht se nuk ka të vërtetë në përmbajtjen e Biblës se ti “ke rënë nga lavdia e Perëndisë”? Nuk ke ndier asnjëherë ndonjë nevojë për Perëndinë në jetën tënde? A nuk ke kaluar në mendje ndonjë mendim se çfarë mund të ketë pas varrit? A është kjo diçka për të cilën je bërë gati të kesh një mundësi? A ka kuptim të hedhësh poshtë ofertën e Perëndisë për faljen e mëkateve dhe për jetën e përjetshme?

Mund të ndodhë që, edhe pasi ta kesh lexuar këtë broshurë, ta gesh veten duke thënë: “Më vërteto se Bibla është e vërtetë”. Nëse është

kështu, përgjigjja ime është: “Vërtetoje vetë!” Kështu ndodh që vargu qendror i Versionit të Autorizuar të Biblës, i botuar për herë të parë më 1611, është një saktësi e përsosur e mesazhit të tij: “Është më mirë të gjesh strehë te Zoti, sesa t’i kesh besim njeriut”.¹¹⁰ Miliona njerëz e kanë vënë në provë këtë pohim dhe kanë zbuluar se është i vërtetë! Tani edhe ti ke një mundësi të veprosh po ashtu. Sër Thomas Taylor, dikur drejtor i Universitetit Aberdeen, shkruajti: “Atje ku bëhet fjalë për Perëndinë e Biblës, njerëzit e kërkojnë atë në po atë mënyrë që miu mesatar kërkon macen mesatare”,¹¹¹ e megjithëse Perëndia është “plot dashuri”¹¹² dhe se “nuk do që ndonjë të humbasë, por që të gjithë të vijnë në pendim”,¹¹³ do të ishte e pamundur të imagjinoje një përgjigje më të marrë. Më lejo të të nxis të mos e bësh këtë gabim tragjik. Përkundrazi, shko te Bibla me mendje sa më të hapur që të mundesh, duke i kërkuar Perëndisë ta bëjë mesazhin e saj të qartë dhe personal dhe të të japë hirin që të përgjigjesh si duhet. Nuk ke asgjë për të humbur, por vetëm për të fituar. Perëndia thotë: “Do të më kërkonit dhe do të më gjeni, sepse do të më kërkonit me gjithë zemrën tuaj”,¹¹⁴ — dhe ai mban çdo premtim!

Shënime

1. Frederic G. Kenyon, "The Bible and Archaeology", Harper & Row, f. 288.
2. Shiko Norman L. Geisler dhe William E. Nix, "A General Introduction to the Bible", Moody Press, f. 367.
3. Brian H. Edwards, "Nothing But the Truth", Evangelical Press (botimi i dytë, 1993), f. 179.
4. Frederic G. Kenyon, "Our Bible and the Ancient Manuscripts", Harper & Brothers, f.23.
5. "The Chambers Dictionary", Chambers, f.1069.
6. Zanafilla 1:1.
7. Henry M. Morris, "The Biblical Basis for Modern Science", Baker Books House, f. 87.
8. "The Times", 13 korrik 1984.
9. Bertrand Russell, "Religion and Science", Oxford University Press, f. 243.
10. Karl Popper, "The Logic of Scientific Discovery", Unwin Hyman Ltd, f. 280.
11. Shiko Dave Hunt, "In Defence of the Faith", Harvest House Publishers, f. 69.
12. Cituar nga Edwards, "Nothing but the Truth", f. 294.
13. Cituar nga Henry M. Morris, "Man of Science – Man of God", Master Books, f. 15.
14. Galatasve 5:22.
15. Brian H. Edwards, "Grace – Amazing Grace", Day One Publications, f. 69.
16. Eksodi 20: 1-17.
17. Bertrand Russell, "Why I am not a Christian", Watts & Co., f. 9.
18. "Daily Telegraph", 28 maj 1996.
19. Robert Dick Wilson, "A Scientific Investigation of the Old Testament", Moody Press, f. 70-71.
20. Ibid.
21. William F. Albright, "The Christian Century", 19 nëntor 1958, f. 1329.
22. William Ramsay, "The Bearing of Recent Discovery on the Trustworthiness of the New Testament", Hodder & Stoughton, f. 222.
23. Nelson Glueck, "Rivers in the Desert: History of Neteg", Jewish Publication Society of America, f. 131.
24. 2 Mbretërve 22:2.
25. 2 Mbretërve 21:26.
26. 2 Samuelit 14:27.
27. 2 Samuelit 18:18.
28. Mateu 12:40.
29. Shiko Luka 24:4.
30. Shiko Mateu 28:2.
31. Shiko Mateu 24:40.
32. Shiko Luka 17:34.
33. R. C. Sproul, "Reason to Believe", Zondervan Publishing House, f. 26.
34. Cituar nga Hunt, "In Defense of the Faith", f. 144.

35. Simon Greenleaf, "The Testimony of Evangelicals: Examined by the Rules of Evidence Administered in the Courts of Justice", Baker Book House, f. 2.
36. "TIME", 30 dhjetor 1974.
37. J. I. Packer, në parathënie të Edmund P. Clowney, The Unfolding Mystery, Inter-Varsity Press, f. 8-9.
38. Romakëve 3:2.
39. 1 Korintasve 14:37.
40. 1 Thesalonikasve 2:13.
41. 1 Pjetrit 1:12.
42. Zbulesa 1:2.
43. Zbulesa 22:6.
44. 2 Timoteut 3:16.
45. 2 Pjetrit 1:21.
46. John Frame, "Apologetics to the Glory of God", P & R Publishing, f. 121.
47. 1 Pjetrit 1:23.
48. Hebrenjve 6:13.
49. Cituar nga Edwards, "Nothing But the Truth", f. 38.
50. Josh McDowell and Bart Larson, "Jesus, A Biblical Defense of His Deity", Crossway Books.
51. Gjoni 10:35.
52. Luka 24:44.
53. Shiko Mateu 22:31-32; Eksodi 3:6.
54. Marku 7: 9-10.
55. Marku 12:36; shiko Psalmi 110:1.
56. Daily Mail, 28 maj 1997.
57. Ligji i Përtërirë 18:22.
58. Shiko Peter W. Stoner, "Science Speaks", Moody Press, f. 67-96 për këtë dhe ilustrime të tjera.
59. John Benton, "Looking for the Answer", Evangelical Press, f. 14.
60. Shiko 1 Korintasve 6:9-11.
61. John R. W. Stott, "Issues Facing Christians Today", Marshall, Morgan & Stott, f. 19.
62. "The Book of Knowledge", The Waverley Book Company Limited, f. 452.
63. Sproul, "Reason to Believe", f. 31-32.
64. Mateu 27:5.
65. Luka 10: 37.
66. Gjoni 13: 27.
67. J. I. Packer, "God Has Spoken", Hodder & Stoughton, f. 106.
68. 1 Korintasve 8:4.
69. Psalmi 103:8.
70. Peter Moore, "Disarming the Secular Gods", Inter-Varsity Press, f. 158.
71. Mateu 28:19.
72. Gjoni 4:24.
73. Ligji i Përtërirë 33:27.
74. Psalmi 90:2.
75. 1 Mbretërve 8:27.

76. Jakobi 1:17.
77. 1 Gjonit 1:5.
78. 1 Gjonit 4:8.
79. Psalmi 33:5.
80. Zanafilla 1:1.
81. Hebrenjve 11:3
82. Veprat 14:15.
83. Zanafilla 1:27.
84. Zanafilla 1:31.
85. Efesianëve 4:24.
86. Romakëve 5:12.
87. Romakëve 8:21.
88. Romakëve 3:23.
89. Marku 7:21-22.
90. Psalmi 51:5.
91. Efesianëve 2:3 në J. B. Phillips, "Letters to Young Churches", Geoffrey Bles.
92. 1 Gjonit 1:8.
93. Mateu 9:12.
94. Fjalët e Urta 11:19.
95. Hebrenjve 9:27.
96. 2 Thesalonikasve 1:9.
97. Mateu 23:33.
98. Luka 16:28.
99. Mateu 25:46.
100. Isaia 64:6.
101. Jeremia 17:9.
102. Gjoni 3:16.
103. Hebrenjve 4:15.
104. Romakëve 1:4.
105. Romakëve 6:9.
106. Hebrenjve 7:25.
107. Veprat 1:3
108. 1 Pjetrit 1:4.
109. Robert Horn, "The Book that Speaks for Itself", Inter-Varsity Press, f. 7.
110. Psalmi 118: 8, Authorized/King James Version.
111. T. Taylor, "Where One Man Stands", Saint Andrew Press, f. 84.
112. Psalmi 103:8.
113. 2 Pjetrit 3:9.
114. Jeremia 29:13.